

M.Sc. Lirije Bytyqi-Beqiri & Gani Gajraku



ZGJEDHJA DHE PLANIFIKIMI I MËSIMIT ZGJEDHOR NË ARSIMIN FILLOR

Prishtinë, 2013

M.Sc. Lirije Bytyqi- Beqiri
Gani Gajraku

**ZGJEDHJA DHE PLANIFIKIMI I MËSIMIT ZGJEDHOR
NË ARSIMIN FILLOR
Raport Hulumtimi**

Prishtinë, 2013

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Autorë:

M.sc. Lirije Bytyqi-Beqiri

Gani Gajraku

Për botuesin:

M.sc. Nezir Çoçaj

Ekipi hulumtues:

M.sc. Lirije Bytyqi-Beqiri- hulumtuese

Gani Gajraku- hulumtues

Ajete Binaku- mësimsdhënëse

Lektor:

Gani Gajraku

Përgatitja teknike:

M.sc. Lirije Bytyqi-Beqiri

Skender Mekolli

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	4
HYRJE.....	7
I. POLITIKAT ARSIMORE DHE PROGRAMET ORIENTUESE PËR MËSIMIN ZGJEDHOR.....	11
1.1. Politikat arsimore	11
1.2. Programet orientuese	14
1.3. Organizimi i mësimit zgjedhor	16
II. METODOLOGJIA.....	23
2.1. Objekti dhe qëllimi i hulumtimit	23
2.2. Dizajni i hulumtimit	24
2.3. Popullata dhe mostra	25
2.3.1. Përbërja e mostrës së hulumtimit me drejtorë të shkollave	27
2.3.2. Përbërja e mostrës së hulumtimit me mësime dhënëse	29
2.3.3. Përbërja e mostrës së hulumtimit me nxënës.....	31
2.4. Instrumentet e hulumtimit	33
2.5. Procedura e mbledhjes së të dhënave	34
2.6. Procedura e analizimit të të dhënave	35
III. REZULTATET E HULUMTIMIT	37
3.1. Përkufizimi i mësimit zgjedhor.....	37
3.2. Arsyeja për organizimin e mësimit zgjedhor	42
3.3. Funksionimi i mësimit zgjedhor	44
3.4. Zgjedhja e mësime dhënëse të mësimit zgjedhor.....	47
3.5. Përzgjedhja e lëndës së mësimit zgjedhor	51
3.7. Vështirësitë në realizimin e mësimit zgjedhor.....	74
3.8. Komente të pjesëmarrësve në hulumtim.....	79
IV. GJETJET KRYESORE TË HULUMTIMIT	83
4.1. Gjetjet që kanë të bëjnë me përkufizimin e mësimit zgjedhor... ..	83
4.2. Gjetjet që kanë të bëjnë me organizimin e mësimit zgjedhor	84
4.3. Gjetjet që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e lëndës zgjedhore	85
4.4. Gjetjet që kanë të bëjnë me planifikimin e mësimit zgjedhor	86
4.5. Gjetjet që kanë të bëjnë me vështirësitë të cilat shfaqen gjatë realizimit të mësimit zgjedhor dhe përkrahjen e mësime dhënëse	87
V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	95
5.1. Përfundime	95
5.2. Rekomandime.....	98
BURIMET	102

Parathënie

Kurrikula Zgjedhore, si pjesë e Kurrikulës Bërthamë, ka për qëllim t'u ofroj mundësi nxënësve të zgjedhin lëndë, kurse, projekte apo module në bazë të dëshirës, interesit dhe nevojave të tyre. Udhëzimet për mënyrën e organizimit të mësimiit zgjedhor jepen në pjesën e udhëzimeve për zbatimin e programeve mësimore në Planet dhe Programet zyrtare të hartuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë.

Organizimi i mësimiit zgjedhor në Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ka mbështetje ligjore. Ligji për Arsim Parauniversitar nr. 04/L-032 parasheh Kurrikulën me bazë në shkollë dhe përcakton ndarjen e kohës për zbatimin e saj, ndërsa mënyrën e organizimit të mësimiit zgjedhor e rregullon Udhëzimi Administrativ për organizimin e mësimiit zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar numër MASHT [I] 1/2005; datë: 06.01.2005 .

Përmes këtij hulumtimi kemi synuar të marrim përgjigje në pyetjet:

- Si është kuptuar dhe përvetësuar qëllimi i lëndës zgjedhore në shkolla nga faktorët relevant?
- Si bëhet përzgjedhja e lëndës zgjedhore në arsimin fillor?
- Si dhe kush i harton programet mësimore për lëndën e mësimiit zgjedhor?
- Cilat janë vështirësitë që hasen më shpesh gjatë zbatimit më programit të mësimiit zgjedhor?

Hulumtimi i ka parapri shqyrtimi i literaturës, ku kemi bërë analizën e politikave arsimore dhe programeve orientuese për mësimin zgjedhor. Në mënyrë që hulumtimi të realizohet me sukses dhe që të dhënat e mbledhura të jenë sa më të besueshme,

është nevojitur të sigurohen informacione nga shkollat. Të dhënat i kemi mbledh me anë të pyetësorëve. Për mostër përzgjedhëm nxënës të shkollave fillore, mësimdhënës klase si dhe drejtorë të shkollave.

Nga hulumtimi del se statusi i lëndës zgjedhore nuk është kuptuar drejt nga mësimdhënësit e shkollës fillore. Arsye për organizimin e mësimit zgjedhor del të jetë plotësimi i njohurive të nxënësve që mbesin mbrapa në mësim. Numri më i madh i drejtorëve të shkollave të përfshirë në hulumtim pohojnë se mësimin zgjedhor në shkollën e tyre e organizojnë në bazë të Udhëzimit Administrativ: Organizimi i mësimit zgjedhor në të gjitha nivelet e Arsimit Parauniversitar Nr: MASHT [I] 1/2005 Datë: 06.01.2005, ndërsa shumica e mësimdhënësve pohojnë se nuk janë të informuar fare se ekziston një udhëzim i tillë dhe se mësimin zgjedhor e rregullojnë në baza individuale, në bazë të teksteve që posedojnë, në bashkëpunim me mësimdhënësit e tjerë apo zgjedhin lëndë të cilat mësimdhënësit vlerësojnë se u nevojiten nxënësve më shumë. Mësimdhënës i lëndës zgjedhore në arsimin fillor në të shumtën e rasteve është mësimdhënësi i klasës.

Përzgjedhja e lëndës zgjedhore bëhet nga mësimdhënësit. Për mësimin zgjedhor mësimdhënësit zgjedhin lëndë të cilat janë sugjeruar për lëndë zgjedhore nga MASHT-i në Planet dhe Programet Zyrtare të klasave përkatëse apo nga lëndët e obliguara. Nuk u jepet mundësi nxënësve, prindërve e as të interesuarve tjerë që të deklarohen për lëndë, kurse, projekte apo veprimtari të reja të cilat janë në interes të nxënësve.

Lëndët zgjedhore të cilat realizohen në arsimin fillor janë: Edukata Shoqërore, Matematika, Gjuha Shqipe, Ekologjia dhe Mjedis, Higjiena dhe Shëndeti, Edukata Shëndetësore, etj. Lënda më e pranishme për mësimin zgjedhor në klasën e dytë

dhe të tretë është Edukatë shoqërore, në klasën e katërtë është lënda e Matematikës, ndërsa në klasën e pestë është Ekologjia dhe Mjedisi.

Sipas të dhënave që kemi nga drejtorët e shkollave del se për lëndën e mësimi zgjedhor vendos Këshilli i shkollës, ndërsa mësimdhënësit pohojnë se vendimin për lëndën zgjedhore e marrin vet. Përzgjedhjen e lëndës zgjedhore mësimdhënësit e bëjnë para fillimit të vitit shkollor.

Planet dhe programet e mësimi zgjedhor i hartojnë vet mësimdhënësit. Nxënësit nuk marrin pjesë në hartimin e tyre. Arsyet pse nxënësit nuk përfshihen në hartimin e planeve dhe programeve mësimore janë të ndryshme. Meqenëse mësimdhënësit njohin mirë strukturën e klasës, zgjedhin përmbajtje të cilat vlerësojnë se nevojiten më tepër për nxënës. Nxënësit ndonjëherë propozojnë tema/njësi mësimore që dëshirojnë ti mësojnë në lëndën zgjedhore por ndodh që as propozimet e tyre ndonjëherë të mos merren parasysh.

Vështirësitë me të cilat ballafaqohen shkollat, e në veçanti mësimdhënësit gjatë realizimit të mësimi zgjedhor janë të shumta. Mungesën e kapaciteteve për planifikim dhe realizim të mësimi zgjedhor në përputhje me kërkesat e nxënësve, mospërfilljen e kërkesave të nxënësve dhe mungesën e kabineteve drejtorët i cekin si vështirësitë më të mëdha me të cilat ballafaqohen. Ndërsa për mësimdhënësit, vështirësitë më të mëdha paraqesin: mungesa e teksteve, mungesa e mjeteve mësimore, kuadri përkatës, përsëritja e vazhdueshme e një lënde të njëjtë në cilësinë e lëndës zgjedhore, hartimi i planeve dhe programeve mësimore dhe zbatimi i planeve dhe programeve. Sipas mësimdhënësve, lënda zgjedhore është ngarkesë për ta. Për mësimin zgjedhor kërkojnë tekste adekuate mësimdhënës të veçantë për këtë lëndë.

HYRJE

Dekada e fundit karakterizohet me reforma arsimore në të gjitha nivelet e arsimit, si në themelimin e institucioneve kompetente ashtu edhe në krijimin e infrastrukturës ligjore dhe profesionale. Në këtë periudhë u hartuan dhe aprovuan ligje dhe udhëzime administrative si dhe dokumente të cilat e rregullojnë funksionimin e institucioneve edukativo-arsimore.

Korniza e Kurrikulës paraqet dokumentin kryesor për reformimin e sistemit arsimor parauniversitar e cila promovon një qasje që bazohet në kompetenca, të cilat zhvillohen përmes të nxënit dhe punës praktike. Zbatimin e saj e mundëson Kurrikula Bërthamë, e hartuar për të tri nivelet. Kurrikula bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor ndër të tjera përfshinë edhe Kurrikulën Zgjedhore për nivelin e parë. Kurrikula Zgjedhore përcaktohet nga shkolla dhe është paraparë me qëllim që nxënësit të zgjedhin module të ndryshme sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesimit.

Në Udhëzimin Administrativ, numër MASHT [I] 1/2005, datë 06.01.2005, janë përcaktuar qartë kriteret për organizimin e mësimit zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Ky udhëzim u mundëson shkollave që për mësimin zgjedhor të bëjnë vetorganizimin, të zgjedhin lëndët që do të mësohen si dhe të hartojnë vet planet dhe programet për ato lëndë. Lënda, kursi apo veprimtaria për mësimin zgjedhor mund të sugjerohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ose në bazë të kërkesës së nxënësve, prindërve, arsimtarëve apo komunitetit. Duke ditur se ky udhëzim administrativ ka hyrë në fuqi që nga viti 2005, e pamë të nevojshme të bëjmë një hulumtim për të parë se si bëhet zgjedhja, planifikimi dhe si funksionon lënda zgjedhore në arsimin fillor, meqë ekziston një bazë ligjore e cila

e rregullon një gjë të tillë. Qëllimi i hulumtimit është të identifikojmë dhe të analizojmë pikat e forta dhe mangësitë e përzgjedhjes, hartimit dhe zbatimit të programit zgjedhor në arsimin fillor në Kosovë si dhe të marrim dhe japim rekomandime për hapat e mëtejshëm.

Përmes këtij hulumtimi është studiuar konteksti i shkollës fillore në përzgjedhjen e lëndës apo kursit të mësimi zgjedhor, hartimi dhe zbatimi i planit dhe programit të mësimi zgjedhor, është bërë analizë e dokumentacionit pedagogjik në shkolla dhe marrja e informacioneve të dëshiruara përmes pyetësorëve.

Të dhënat e mbledhura mundësojnë analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe të funksionimit të mësimi zgjedhor në arsimin fillor.

Terminologjia

Korniza e Kurrikulës së Kosovës- është dokument i cili rregullon tërë sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës.

Kurrikula Bërthamë- është dokument në të cilin përcaktohen rezultatet e kompetencave për lëmi të ndryshme, qasjet, metodologjitë, zbatueshmëria, monitorimi, vlerësimi, shpërndarja kohore për fushat e kurrikulës dhe ndërlidhja mes tyre duke mundësuar progres në zhvillimin e kompetencave tek nxënësit. Ky dokument e bënë të zbatueshëm Kornizën e Kurrikulës së Kosovës në shkollat e Kosovës.

Kurrikulë zgjedhore (Kurrikulë me zgjedhje)- është pjesë e Kurrikulës së Përgjithshme e cila përcaktohet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar me planin mësimor në përputhje me interesimet, potencialet, mundësitë, informacionet paraprake të nxënësve dhe me mundësitë e shkollës.¹

Lëndë zgjedhore (Lëndë me zgjedhje)- lënda që nxënësit e zgjedhin sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit.

Plani mësimor- është një dokument nga i cili varet i gjithë organizimi i procesit mësimor në shkollë, në nivel shkalle kurrikulare apo klase të caktuara. Me të përkufizohen fushat e kurrikulës, lëndët mësimore dhe koha nevojshme minimale që shprehet në përqindje apo në numra orësh për arritjen e

¹ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor (klasa parafillore, I, II, III, IV, V), Prishtinë 2012, faqe 96

rezultateve e të nxënit për fushë dhe shkallë kurrikulare të dhëna në Kurrikulën Bërthamë.²

Fondi i orëve- numri i orëve të parapara për lëndën e caktuar.

² Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor (klasa parafillore, I, II, III, IV, V), Prishtinë 2012, faqe 88

I. POLITIKAT ARSIMORE DHE PROGRAMET ORIENTUESE PËR MËSIMIN ZGJEDHOR

1.1. Politikat arsimore

Mësimi zgjedhor zë një vend me rëndësi në të gjitha dokumentet bazë të cilat e rregullojnë funksionimin e arsimit parauniversitar.

- **Ligji për arsimin Parauniversitar**- parasheh edhe Kurrikulumin me bazë shkolle- pjesë e kurrikulimit që përcaktohet nga vetë shkollat apo institucionet arsimore dhe të aftësimit.

Neni 2, pika 6.1, përcakton ndarjen e kohës mësimore për Kurrikulumin Bërthamë dhe atë shkollor, duke pasur parasysh që Kurrikulumi me bazë shkolle të mos kalojë 20 % të totalit.

- **Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës**, rregullon normat e autonomisë dhe fleksibilitetit të shkollës. Në këtë kontekst parasheh edhe planifikimin dhe shfrytëzimin e pjesës zgjedhore të Kurrikulës, përmes së cilës do të krijohet mundësia që shkolla “të hartojë programe fleksibile dhe inovative për këtë pjesë të Kurrikulës në përputhje me nevojat, kontekstet dhe interesat e nxënësve dhe të komunitetit të caktuar.”³

Korniza e Kurrikulës përcakton edhe obligimet që i presin shkollën, DKA-të dhe MASHT-in lidhur me shfrytëzimin e pjesës zgjedhore. Shkolla merr iniciativën për shfrytëzim të Kurrikulës zgjedhore, ofron këshillim në zgjedhjen e nxënësve, ndihmon nxënësit që të kenë përfitime nga mësimi zgjedhor, analizon mundësitë e veta dhe merr vendim për lëndët të cilat do të jenë pjesë e Kurrikulës Zgjedhore, ndërsa DKA-të dhe

³ Ministria e Arsimit e shkencës dhe e Teknologjisë (2011): Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, faqe 45

MASHT-i japin miratimin final për programet e propozuara, monitorojnë dhe vlerësojnë këtë pjesë të Kurrikulës si të gjitha fushat e tjera të Kurrikulës. Planifikimi dhe shfrytëzimi i pjesës zgjedhore të Kurrikulës ofron mundësinë për:

“(a) rritjen e fondit të orëve në kuadër të fushave përkatëse kurrikulare, dhe

(b) zhvillimin dhe zbatimin e elementeve plotësuese kurrikulare për të përmbushur nevojat e veçanta të nxënësve të saj si dhe për të reflektuar rrethanat në të cilat shkolla përkatëse vepron.”⁴

- **Kurrikula Bërthamë** - ka për qëllim që në shkollat e Republikës së Kosovës të bëjë të zbatueshme Kornizën e Kurrikulës së Kosovës. “Me këtë dokument përcaktohen rezultatet e kompetencave për lëmenj të ndryshëm të jetës, të shprehura nëpërmjet njohurive faktike dhe procedurale, nëpërmjet shkathtësive, qëndrime dhe vlerave që duhet të zhvillohen te nxënësit gjatë periudhave të caktuara kohore si dhe qasjet, metodologjitë e zbatueshmërisë, monitorimi dhe vlerësimi.”⁵ Si pjesë e strukturës së Kurrikulës bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor është edhe mësimi me zgjedhje. Kapitulli V i kushtohet Kurrikulës Zgjedhore për nivelin e parë. Aty sqarohen koncepti, qëllimi, përmbajtja dhe realizimi, struktura, procedurat për hartimin e Kurrikulës Zgjedhore, procedurat për zgjedhjen e lëndës zgjedhore dhe zbatimin të saj.

“Kurrikula Zgjedhore është pjesë e Kurrikulës së Përgjithshme, e cila, ndryshe nga Kurrikula Bërthamë, përcaktohet nga shkolla

⁴ Ministria e Arsimit e shkencës dhe e Teknologjisë (2011): Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, faqe 26

⁵ Ministria e Arsimit e shkencës dhe e Teknologjisë (2012): Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor (klasa parafillore, I, II, III, IV, V), faqe 10

dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar me planin mësimor në përputhje me interesimet, potencialet, mundësitë, informacionet paraprake të nxënësve dhe me mundësitë e shkollës.”⁶

- Udhëzimi Administrativ Organizimi i mësimit zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar numër MASHT [I] 1/2005; datë: 06.01.2005- rregullon funksionimin e mësimit zgjedhor. Në këtë Udhëzim administrativ sqarohen dilemat rreth zgjedhjes, planifikimit dhe organizimit të mësimit zgjedhor.

Neni 3 i këtij udhëzimi administrativ përcakton mënyrën e organizimit të mësimit zgjedhor. Aty parashihet që mësimi zgjedhor të organizohet për lëndë apo kurse të reja të cilat do të jenë joshëse për nxënësit dhe me interes për komunitetin.

Udhëzimi gjithashtu parasheh edhe mënyrën e deklarimit të nxënësve, prindërve apo të interesuarve të tjerë, kohën kur bëhet deklarimi, vendimin që duhet ta marrin organet profesionale, si dhe kohën kur duhet të kryhen këto procedura.

“Mësimi zgjedhor kur të aprovohet nga organet profesionale të shkollës e ka statusin e mësimit të rregullt, më të vetmin përjashtim që mësimi zgjedhor do të vlerësohet me notë përshkruese: arritje shumë e lartë, arritje e lartë, arritje e kënaqshme, arritje e kufizuar që realizohet sipas nenit 11 (11.1.-11.4.) të UA. nr. 50/04.”⁷ Planet dhe programet e mësimit zgjedhor i harton shkolla.

Për zgjedhjen dhe organizimin e mësimit zgjedhor informacione të rëndësishme gjejmë edhe në planet dhe

⁶ Ministria e Arsimit e shkencës dhe e Teknologjisë (2012): Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor (klasa parafillore, I, II, III, IV, V) faqe, faqe 96

⁷ Udhëzim Administrativ Organizimi i mësimit zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, faqe 3

programet zyrtare të hartuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

1.2. Programet orientuese

- *Planet dhe programet mësimore zyrtare*- në pjesën e udhëzimeve për zbatimin e programeve mësimore jepen edhe udhëzimet rreth organizimit të mësimit zgjedhor. Pjesa sipas zgjedhjes në Plan dhe në Program i mbetet shkollës. Këtu vjen në shprehje autonomia e shkollës. Shkolla është ajo e cila bënë zgjedhjen, natyrisht duke i përfillur nevojat dhe kërkesat individuale të nxënësve. Në planet dhe programet mësimore jepen udhëzime rreth mënyrës së zgjedhjes, kurseve apo veprimtarive, vendimmarrjen dhe kohëzgjatjen e mësimit zgjedhor.

Zgjedhja e kurseve dhe veprimtarive sipas zgjedhjeve mund të sugjerohen nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ose mund të dalin edhe si propozime nga ana e nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe faktorëve tjerë të interesuar.

Bazuar në *Planin dhe Programin mësimor për klasën e parë fillore* zgjedhja e lëndës zgjedhore mund të bëhet nga lëndët e obligueshme në formë të mësimit plotësues, mund të zgjedhen lëndë apo kurse të reja, tema nga jeta, apo orët e mësimit zgjedhor mund të shfrytëzohen edhe për ekskursione, shëtitje dhe veprimtari për zhvillimin individual.

“Pasi shkolla të vendosë për pjesën zgjedhore të planit dhe të programit (orë plotësuese nga lëndët e obligueshme apo lëndëve/kurseve tjera), zgjidhet kuadri adekuat për udhëheqjen e

mësimin në këto lëndë/kurse gjatë zbatimit.⁸ Për lëndën zgjedhore në klasën e parë fondi i përcaktuar i orëve është 37 orë mësimore në vit që do të thotë se bazuar në fondin e përgjithshëm të orëve të përcaktuar për klasën e parë fillore kjo lëndë ka në dispozicion 5% të orëve mësimore. “Lënda, kursi apo veprimtaria e zgjedhur duhet të zgjasë jo më pak se një gjysmëvjetor.”⁹

Në bazë të *planeve dhe programeve mësimore për klasën e dytë, tretë, katërtë dhe të pestë të arsimit fillor*, mësimi zgjedhor mund të organizohet nga lëndë apo kurse të reja. Në to sugjerohen disa lëndë, si: Edukim qytetar, Etikë, Kurse Shëndetësore, Të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, Edukimi për ndërmarrës, TIK dhe Mbrojtja e mjedisit jetësor. Potencohet se mund të zgjedhën edhe lëndë apo kurse tjera të cilat janë joshëse për nxënësit dhe me interes për komunitetin. Lënda, kursi apo veprimtaria me zgjedhje mund të zgjasë jo më pak se tre muaj. Për lëndën zgjedhore, në klasën e dytë, tretë dhe të katërtë nga MASHT-i sugjerohen 74 orë në vit, respektivisht dy orë në javë. Në planet dhe programet mësimore zyrtare për të gjitha klasat e arsimit fillor theksohet se zgjedhja e lëndës, kursit apo veprimtarisë zgjedhore duhet të bëhet në bazë të dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit të nxënësve, përmes deklaramit të tyre. Në qoftë se klasa ka më shumë se një paralele për lëndën, kursin apo veprimtarinë me zgjedhje duhet të deklarohen së paku pesëmbëdhjetë nxënës, ndërsa në rastet ku klasa ka vetëm një paralele duhet të deklarohen gjysma e nxënësve të klasës.

⁸ Ministria e Arsimit e shkencës dhe e Teknologjisë (2003): Plani dhe programi mësimor për klasën e parë fillore, faqe 15

⁹ Po aty faqe 15

1.3. Organizimi i mësimit zgjedhor

Mësimi zgjedhor ka për qëllim të plotësojë interesat e nxënësve, të zhvillojë më tej prirjet individuale dhe të motivojë të nxënit. Organizimi i mësimit zgjedhor ka rëndësi të madhe për shkollën, nxënësit, mësimdhënësit dhe komunitetin në përgjithësi.

Kurrikula Zgjedhore ndihmon shkollën që për nxënësit e saj të pasurojë kurrikulën me përmbajtje në interes për nxënësit, shkollën dhe komunitetin që e rrethon, e bënë shkollimin më të rëndësishëm për nevojat individuale dhe zhvillimore të nxënësve, e rrit pjesëmarrjen e nxënësve në hartimin e kurrikulës shkollore, etj.

Rëndësia e mësimit zgjedhor për nxënësit qëndron në faktin se: përmbush interesat dhe nevojat specifike të nxënësve, u jep mundësi të deklarohe për prirjet e tyre individuale, ndihmon në zbulimin e talenteve, ndikon në formimin e qëndrimit pozitiv ndaj shkollës, duke e bërë atë më miqësore, i motivon nxënësit, etj.

Shkolla duhet të krijoj mekanizma të cilat mundësojnë që nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe të interesuarit e tjerë të deklarohe për pjesën e Kurrikulës me Zgjedhje. Për të parë se cilat janë nevojat dhe interesimet për Kurrikulën Zgjedhore, shkolla mund të organizoj takime, debate, apo edhe hulumtime (intervista, pyetësorë, etj.), ku do të përfshijë të gjitha palët e interesit. Zgjedhja e lëndëve, kurseve apo veprimtarive zgjedhore mund të bëhet edhe nga lëndë dhe kurse të sugjeruara nga MASHT-i në Planet dhe Programet mësimore.

Në planin dhe programin mësimor për klasën fillore, nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë sugjerohet që kurset apo veprimtaritë sipas zgjedhjes të shërbejnë për orë plotësuese nga lëndët e obligueshme, futjen e lëndëve apo

kurseve të reja, tema nga jeta, apo koha e përcaktuar për mësimin zgjedhor të shfrytëzohet për ekskursione/ shëtitje dhe veprimtari për zhvillimin individual.¹⁰ Ndërsa në planet dhe programet mësimore për klasën e dytë, tretë, katërtë dhe klasën e pestë “mësimi zgjedhor mund të organizohet nga : lëndë apo kurse të reja (p.sh. edukim qytetar, etikë, kurse shëndetësore, të drejtat dhe liritë e njeriut, edukimi për ndërmarrës, TIK, Mbrojtja e mjedisit jetësorë apo çka do që është joshëse për nxënësit dhe me interes për komunitetin.”¹¹

Zgjedhja duhet të jetë në përputhje me kërkesat e nxënësve, kushtet dhe mundësitë e shkollës, specifikat rajonale, etj. Në bazë të Udhëzimit Administrativ “për lëndën, kursin apo veprimtarinë duhet të deklarohen më se paku 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës (në qoftë se klasa ka më shumë se një paralele)” apo “në qoftë se klasa ka vetëm një paralele, atëherë është e nevojshme që për lëndën, kursin apo veprimtarinë të deklarohen se paku gjysma e paraleles- në mënyrë që të mund të organizohet mësimi zgjedhor.”¹²

Mësimdhënësit për lëndën, kursin apo veprimtarinë zgjedhore duhet të konkurrojnë me projekt komplet, i cili duhet të përfshijë planin dhe programin, burimet e informacionit që do të shfrytëzohen dhe mënyrën e realizimit.

Shkolla shqyrton kërkesat e të interesuarve, Organet profesionale vendosin për kurset, lëndët apo veprimtaritë të cilat do të jenë pjesë e Kurrikulës Zgjedhore të shkollës. Miratimi final nga DKA dhe MASHT-i duhet të bëhet para fillimit të vitit

¹⁰ Për këtë shih: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2003): Plani dhe programi mësimor për klasën e parë fillore, Prishtinë, faqe 14

¹¹ Për këtë shih Planet dhe Programet zyrtare të hartuara nga MASHT për klasat përkatëse, faqe 14

¹² Udhëzim Administrativ Organizimi i mësimit zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, faqe 2

shkollor. Pas miratimit, merr statusin e njëjtë me lëndët tjera dhe bëhet e obligueshme për nxënësit.

Pasi që edhe lënda zgjedhore i takon njëres prej fushave të Kurrikulës, planifikimi duhet të bazohet në Kurrikulën Bërthamë. “Planet mësimore për pjesën zgjedhore të Kurrikulës të hartuara nga shkollat do të kenë mbështetjen e shërbimeve pedagogjike nga niveli qendror e lokal.

Të gjitha këto plane dhe programe mësimore do të marrin miratimin e përgjegjësve të arsimit në nivelin lokal dhe qendror para fillimit të zbatimit të tyre.”¹³ Me rastin e konkurrimit, mësimdhënësit aplikojnë me projekt komplet. Përveç përmbajtjeve mësimore, mësimdhënësi duhet të përzgjedh edhe burimet e informacionit, metodat, teknikat dhe teknologjitë e mësimdhënies që do përdor për realizimin e veprimtarive. Të gjitha këto do të jenë në funksion të arritjes së rezultateve mësimore të cilat do të përcaktohen në bazë të shkallës dhe fushës që i përket lënda zgjedhore.

Nga alokimi i fondit të orëve në Kornizën e Kurrikulës¹⁴, shohim se në shkallën e parë, respektivisht në klasën e parë dhe të dytë për pjesën zgjedhore janë paraparë 4.76% e orëve mësimore, ndërsa për shkallën e dytë, respektivisht për klasën e tretë, të katërtë dhe të pestë janë paraparë 8.33% e orëve mësimore.

Tabela . Ndarja e kohës për lëndën zgjedhore sipas Kornizës së Kurrikulës dhe Planeve dhe programeve zyrtare

¹³ Ministria e Arsimit e shkencës dhe e Teknologjisë (2011): Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, faqe 45

¹⁴ Ministria e Arsimit e shkencës dhe e Teknologjisë (2011): Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, faqe 43

	Korniza e Kurrikulës		Planet dhe programet zyrtare				
	ShK1	ShK2	Klasa e parë	Klasa e dytë	Klasa e tretë	Klasa e katërtë	Klasa e pestë
Fondi i orëve	4.76%	8.33%	5%	9.52%	8.70%	8.33%	8.69%

Nga tabela shohim se në bazë të planit dhe programit për klasën e parë fillore për Kurrikulën Zgjedhore parashihen 5% e fondit të orëve, pra 37 orë mësimore në vit, respektivisht 1 orë mësimore në javë. Për klasën e dytë fillore, në planin dhe programin zyrtar, për mësimin zgjedhor janë ndarë 9.52% e fondit të orëve, pra 74 orë mësimore në vit, respektivisht dy orë mësimore në javë. Edhe në planin dhe programin për klasën e tretë fillore, për mësimin zgjedhor janë ndarë 74 orë në vit, respektivisht dy orë në javë ose shprehur në përqindje 8.70% e fondit të orëve. Në planin dhe programin për klasën e katërtë fillore për mësimin zgjedhor janë planifikuar 8.33% e fondit të orëve, pra 74 orë në vit ose 2 orë në javë, ndërsa në planin dhe programin për klasën e pestë fillore janë planifikuar 8.69% e fondit të orëve; 74 orë mësimore në vit, respektivisht 2 orë mësimore në javë. Kohëzgjatja e lëndëve, kurseve apo veprimtarive të ofruara për mësim zgjedhor përcaktohet nga organet profesionale të shkollës. Kohëzgjatja e tyre dallon varësisht nga plotësimi i kërkesave dhe përbushja e nevojave të nxënësve. Në bazë të udhëzimeve të dhëna nga MASHT-i,

lënda, kursi apo veprimtaria zgjedhore duhet të zgjatë jo më pak se tre muaj.

Sikurse edhe në lëndët tjera, edhe në lëndën zgjedhore nxënësi duhet të vlerësohet për arritjet e tij. Në lëndën zgjedhore vlerësimi bëhet me notë përshkruese jo negative, sipas kriterëve të parapara në Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve nr. 50/04.

Neni 11 (11.1-11.4) i këtij udhëzimi përcakton kriteret e vlerësimit sipas aftësive në nxënie në lëndën zgjedhore.

Me *arritje shumë e lartë* vlerësohet nxënësi i cili ka arritje shumë të lartë në:

- Njohjen dhe zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta,
- të kuptuarit dhe të zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak-efekt, mbledhjes dhe organizimit të informatave, të gjykuarit e thjeshtë, Të menduarit kritik në situata komplekse si: njohja e informacioneve relevante, zgjidhja e problemeve duke i zbatuar parimet ushtrimet e interpretoeshme etj.

Me *arritje e lartë* vlerësohet nxënësi i cili ka aftësi të larta në:

- Njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta,
- Të kuptuarit dhe të zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak-efekt, mbledhjes dhe organizimit të informatave, të gjykuarit e thjeshtë.
- Të menduarit kritik në situata komplekse si: Njohja me informatat relevante, zgjidhja e problemeve duke i zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretoeshme.

Me *arritje e kënaqshme* vlerësohet nxënësi i cili ka aftësi mesatare në:

- Njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta,
- Të kuptuarit dhe të zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak-efekt, mbledhjes dhe organizimit të informatave, të gjykuarit e thjeshtë.
- Të menduarit kritik në situata komplekse si: Njohja me informatat relevante, zgjidhja e problemeve duke i zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpreteshme.

Me *arritje e kufizuar* vlerësohet nxënësi i cili ka aftësi të kufizuar në:

- Njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta,
- Të kuptuarit dhe të zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak-efekt, mbledhjes dhe organizimit të informatave, të gjykuarit e thjeshtë.
- Të menduarit kritik në situata komplekse si: Njohja me informatat relevante, zgjidhja e problemeve duke i zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpreteshme.

Nga momenti kur të aprovohet mësimi zgjedhor merr statusin e mësimi të rregullt.

II. METODOLOGJIA

Të dhënat e mbledhura përmes hulumtimit lidhen me mënyrën e organizimit, llojin dhe arsyet e realizimit të mësimit zgjedhor, si dhe me lëndët, modulet apo kurset me zgjedhje që ofron shkolla. Gjatë realizimit të hulumtimit jemi mbështetur në metodologjinë kuantitative dhe kualitative.

Për ta realizuar këtë hulumtim, kemi kaluar në disa faza:

- i. Analiza teorike–shqyrtimi i dokumente të cilat e rregullojnë funksionim e mësimit zgjedhor në Arsimin Parauniversitar.
- ii. Puna në terren- realizimi i hulumtimit në komuna, mbledhja e të dhënave përmes pyetësorëve lidhur me zgjedhjen, planifikimin dhe organizimin e mësimit zgjedhor në Arsimin fillor.
- iii. Analiza e të dhënave- përmes programit SPSS-16.
- iv. Raporti i hulumtimit- bazuar në të dhënat e mbledhura.

Hulumtimi është fokusuar në tri çështje kryesore:

1. Politikat arsimore dhe programet orientuese për mësimit zgjedhor,
2. Praktikave shkollave në organizimin e mësimit zgjedhor,
3. Nevojat e shkollës/mësimdhënësve për mbështetje rreth zgjedhjes, planifikimit dhe organizimit të mësimit zgjedhor

Pjesëmarrës në këtë hulumtim janë nxënës, mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave fillore.

2.1. Objekti dhe qëllimi i hulumtimit

Objekt i hulumtimit është Mësimi zgjedhor. Qëllimi ynë ishte identifikimi dhe analiza e pikave të forta dhe të dobëta të përzgjedhjes, hartimit dhe zbatimit të planit dhe programit të

mësimi zgjedhor në disa shkolla fillore në Kosovë si dhe dhënia e rekomandimeve për hapat e mëtuftjeshëm me qëllim të përmirësimit të funksionimit të mësimi zgjedhor.

Bazuar në qëllimin e huluntimit shtrohen edhe objektivat e huluntimit. Objektivat kryesore të huluntimit ishin:

- Të identifikojmë gjendjen aktuale lidhur me përzgjedhjen dhe planifikimin e mësimi zgjedhor,
- Të identifikojmë format e organizimit të mësimi zgjedhor në shkollat tona,
- Të huluntojmë pjesëmarrjen e nxënësve dhe grupeve të tjera me interes në përzgjedhjen dhe planifikimin e mësimi zgjedhor,
- Të vlerësojmë mundësitë dhe nevojat e mësimdhënësve për përgatitjen e materialeve mësimore kreative për mësimin zgjedhor.
- Të ofrojmë rekomandime për përmirësimin e gjendjes aktuale në këtë aspekt,

Ideja për huluntim doli nga diskutimet me mësimdhënës të shkollave të ndryshme gjatë punës në terren, ku shpesh kemi hasur në mendime se ka një mospërputhje në mes të dispozitave normative dhe praktikave shkollore sa i përket organizimit të mësimi zgjedhor.

2.2. Dizajni i huluntimit

Huluntimi është kryer në njëmbëdhjetë shkolla fillore në tetë komuna të Republikës së Kosovës. Responentë kishim nxënës të klasave të dyta, të treta, të katërta dhe të pesta, mësimdhënës të arsimit fillor, si dhe drejtorë të shkollave fillore. Për mbledhjen e të dhënave jemi shërbyer me pyetësorë (pyetësor për mësimdhënës, pyetësor për nxënës dhe pyetësor për drejtor të shkollave). Analizën e të dhënave e kemi bërë me programin

kompjuterik SPSS-16.

2.3. Popullata dhe mostra

Popullatën e këtij studimi e përbëjnë drejtorët, mësimdhënësit dhe nxënësit e Arsimit fillor në Kosovë. Për mostër kemi zgjedhur drejtorë, mësimdhënës dhe nxënës të tetë komunave: Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Junik, Malishevë, Ferizaj, Drenas dhe Skenderaj.

Mostra e këtij hulumtimi ishte heterogjene, tri shtresore.

Tabela 1. Përbërja e mostrës së hulumtimit

Nr	Komuna	Nxënës		Mësimdhënës		Drejtor		Gjithsej
		F	M	F	M	F	M	
1	Prishtinë	24	21	10	-	-	2	57
2	Podujevë	19	21	9	1	-	2	52
3	Obiliq	9	11	4	-	1	-	25
4	Junik	10	10	3	1	-	1	25
5	Malishevë	18	30	6	4	-	2	60
6	Ferizaj	11	8	1	3	-	1	24
7	Drenas	13	7	3	1	-	1	25
8	Skenderaj	23	18	13	2	1	-	57
	Gjithsej	127	126	49	12	2	9	325

Siç shihet nga tabela 1, mostrën e përzgjedhur për hulumtim e përbëjnë 253 nxënës, 61 mësimdhënës dhe 11 drejtorë të shkollave fillore të mesme të ulëta. Respodentët janë nga komunat: Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Junik, Malishevë, Ferizaj, Drenas dhe Skenderaj. Mostra e shkollave për këtë studim ishte zgjedhur sipas rastit. Janë përzgjedhur 10 shkolla, të cilat janë përfshirë në studim.

Për të bërë krahasime mes përgjigjeve të dhëna, respondentët i kemi përzgjedhur nga e njëjta shkollë. Mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim janë të klasave të para, të dyta, të treta, të katërta dhe të pesta. Po ashtu, edhe nxënësit e përzgjedhur janë nga klasat ku japin mësim mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim, pra nga klasat e dyta, të treta, të katërta dhe të pesta.

Sa i përket përfaqësimit gjinor, tek nxënësit është bërë në mënyrë të barabartë. Nuk ka qenë e mundur që mostrën e drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve ta ndajmë në proporcion të barabartë sa i përket gjinisë.

Siç shihet nga tabela 1, numri më i madh i mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim ishin femra, ndërsa numri më i madh i drejtorëve ishin meshkuj, sepse, në arsimin fillor mësimdhënësit meshkuj janë të paktë në numër në krahasim me numrin e mësimdhënësve femra, përderisa numri i drejtorëve meshkuj është dukshëm më i madh sesa numri i drejtoreshave femra.

2.3.1. Përbërja e mostrës së hulumtimit me drejtorë të shkollave

Në hulumtim gjithsej janë përfshirë 11 drejtorë të shkollave. Drejtorët janë nga komuna të ndryshme, nga shkollat e përfshira në hulumtim. Mosha e tyre dhe përgatitja shkollore është e ndryshme.

Tabela 2. Struktura e mostrës së drejtorëve të shkollave

		Nr	%
GJINIA	F	2	18.18
	M	9	81.81
MOSHA	31-40 vjeç	1	9.1
	41-50 vjeç	6	54.5
	51-60 vjeç	4	27.3
KUALIFIKIMI	Fakultet	8	72.7
	Master/Magjistër	3	27.3
	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	3	27.3
	Filozofi- Sociologji	2	18.2
	Pedagogji	2	18.2
	Udhëheqja në arsim	1	9.1
	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	1	9.1
PROGRAMI	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	1	9.1
	Histori- Gjeografi	1	9.1
	TIK	1	9.1

Në tabelën 2 kemi paraqitur strukturën e mostrës së drejtorëve të përfshirë në hulumtim. Nga tabela shihet se, 18.18% e drejtorëve të shkollave janë femra, ndërsa 81.81 janë meshkuj. Mosha e tyre lëvizë nga 31-60 vjeç ku, 9.1% prej tyre janë të moshës 31-40 vjeç, 54.5% janë të moshës 41-50 vjeç,

ndërsa 27.3% janë të moshës 51-60 vjeç. Nga këto të dhëna shohim se shumica e drejtorëve të përfshirë në hulumtim janë meshkuj të moshës 41-50 vjeç.

Drejtorët e përfshirë në hulumtim janë me arsim të lartë, ashtu siç edhe rregullohet me Udhëzimin Administrativ: Procedurat e zgjedhjes së drejtorit të shkollës numër: 11/2008.

Nga të dhënat që shohim në tabelën 2, del se mbi 72% e tyre kishin kryer nivelin e parë të arsimit të lartë-fakultetin, ndërsa 23.7% kanë përfunduar studimet në nivelin e dytë të arsimit të lartë-master/magjistraturë.

Nga paraqitja tabelore po ashtu shohim se studimet që kanë përfunduar drejtorët e shkollave i përkasin programeve të ndryshme. Me Gjuhë Shqipe dhe Letërsi janë 27.3% prej tyre, 18.2% kishin kryer studimet në programin Filozofi-Sociologji, po ashtu 18.2% në programin Pedagogji. Të kualifikuar në programin Udhëheqja në arsim janë 9.1% e drejtorëve të shkollave të përfshira në hulumtim, e po me të njëjtën përqindje del të jenë edhe drejtorët që kanë kryer studimet në programet: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, Histori-Gjeografi dhe TIK.

Drejtorët e përfshirë në hulumtim janë me përvojë të gjatë pune në arsim qoftë me përvojën e tyre paraprake në mësimdhënie apo edhe në pozitën e drejtorit të shkollës. Me përvojë pune mbi 20 vjeçare në mësimdhënie janë 54.5% e drejtorëve të shkollave, 18.2% prej tyre kanë përvojë 11-20 vite pune në mësimdhënie, po ashtu 18.2% kanë 2-10 vite përvojë pune në mësimdhënie, ndërsa 9.1% e drejtorëve nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

Sa i përket përvojës së tyre në cilësinë e drejtorit të shkollës, 54.5% prej tyre janë me 2-5 vite përvojë, 18.2% janë me 6-10 vite përvojë si drejtor shkolle, dhe 18.2% kanë përvojë mbi 10

vite si drejtor shkolle, që do të thotë se afërsisht 40% e drejtorëve të shkollave janë drejtorë shkolle që vazhdojnë mandatin e dytë ose të tretë në detyrën/rolin e drejtorit të shkollës.

2.3.2. Përbërja e mostrës së hulumtimit me mësimdhënës

Mostrën e hulumtimit e përbëjnë 61 mësimdhënës të arsimit fillor. Mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim janë mësimdhënës të klasave të para, dyta, treta, katërta dhe të pesta.

		nr	%
GJINIA	F	49	80.3
	M	12	19.7
MOSHA	21-30	11	18
	31-40	16	26.2
	41-50	13	21.3
	51-60	10	16.4
	Mbi 60	11	18
KUALIFIKIMI	SHLP	38	62.3
	Faluktet	23	37.7


Tabela3. Struktura e mostrës së mësimdhënësve

Nga të dhënat në tabelën 3 mund të përfundojmë se numri më i madh i mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim, respektivisht 80.3% prej tyre ishin femra, ndërsa vetëm 19.7% ishin meshkuj.

Shumica prej tyre, 26.2% janë të moshës 31-40 vjeç, 21.3% janë të moshës 41-50 vjeç, 18% janë të moshës 21-30 vjeçe, po ashtu 18% janë të moshës mbi 60 vjeçe, dhe 16.4% e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim janë të moshës 51-60 vjeç.

Sa i përket kualifikimit, numri më i madh i mësime dhënëseve, 62.3% kanë përfunduar shkollimin në Shkollën e Lartë Pedagogjike (SHLP), ndërsa 37.7% kanë kryer studimet në nivelin e parë të arsimit të lartë- fakultet. Në nivelin e parë të arsimit të lartë, mësime dhënësit kanë studiuar në programe të ndryshme.

Grafiku 1. Programet e studimit të mësime dhënëseve




Nga paraqitja grafike shohim se shumica e mësime dhënëseve të përfshirë në hulumtim, respektivisht 47.5% prej tyre kanë përfunduar studimet në programin Mësim klasor, 9.8% kanë përfunduar studimet në programin Fillor. Një numër i mësime dhënëseve, 9.2% prej tyre nuk kanë cekur programin në të cilin kanë studiuar, prandaj edhe në paraqitjen grafike i kemi shënuar me pikëpyetje për arsye se nuk e dimë llojin e programit, 8.2% e mësime dhënëseve kanë përfunduar Shkollën Normale ndërsa 6.6% kanë përfunduar studimet në programin Pedagogji. Me 3.3% janë mësime dhënësit të cilët kanë përfunduar studimet në programet: Gjuhë dhe Letërsi shqipe, Matematikë, ndërsa në programet: Mësuesi, Gjuhë shqipe, Grafikë dhe Edukatë Fizike janë 1.6% të mësime dhënëseve.

Nga këto të dhëna mund të përfundojmë se numri më i madh i mësimit fillor të shkollës fillore të përfshirë në hulumtim kanë përfunduar studimet në programin mësimi klasor.

Mësimit fillor të përfshirë në hulumtim janë mësimit fillor me përvojë pune disaveçare në arsim, ku 42.6% prej tyre janë me përvojë pune mbi 20 vjeçare, 29.5 % kanë përvojë pune 10 vjeçare, 23% kanë 11-20 vite përvojë pune në arsim, 3.3% kanë përvojë pune 1 vjeçare ndërsa 1.6% e mësimit fillor nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

Pra siç shohim nga paraqitja grafike, shumica e mësimit fillor të përfshirë në hulumtim janë me përvojë pune mbi 20 vjeçare në arsim.

Grafiku 2. Përvoja e mësimit fillor në arsim



2.3.3. Përbërja e mostrës së hulumtimit me nxënës

Mostrën e hulumtimit me nxënës e përbëjnë 253 nxënës të arsimit fillor. Prej tyre 127 ose 50.2% janë femra, ndërsa 126 ose 49.8% janë meshkuj. Janë përfshirë nxënës të klasave të dyta, të treta, të katërta dhe të pesta.

KLASA	E Dytë		E Tretë		E Katërtë		E Pestë		Gjithsej	
	M	F	M	F	M	F	M	F	Nr.	%
6 vjeç	2	-	-	-	-	-	-	-	2	0.8
7 vjeç	14	16	2	-	-	-	-	-	32	12.6
8 vjeç	6	3	13	19	1	4	-	-	46	18.2
9 vjeç	1	1	13	9	19	19	1	1	64	25.3
10 vjeç	2	-	9	11	9	11	29	29	81	32
11 vjeç	1	-	-	-	-	-	13	14	28	11.1
Gjithsej	Nr.	46	57		63		87		253	
	%	18.2	22.5		24.9		34.4		100	

Tabela 4. Struktura e moshës së nxënësve

Nga tabela 4 shohim se moshë e nxënësve të përfshirë në hulumtim lëvizë nga 6-11 vjeç.


Nxënës të moshës 6 vjeç janë 2 ose 0.8% prej tyre, të moshës 7 vjeç janë të përfshirë 32 nxënës ose 12.6%, 46 nxënës ose 18.2% janë të moshës 8 vjeç, 64 ose 25.3% janë të moshës 10 vjeç dhe 28 ose 11.1% e nxënësve të përfshirë në hulumtim janë të moshës 11 vjeç.

Nxënësit e klasës së parë nuk janë përfshirë në hulumtim, sepse në klasën e parë zgjedhja e lëndës zgjedhore bëhet nga lëndët e obligueshme, zakonisht orë plotësuese në lëndët Gjuhë Shqipe dhe Matematikë.

Në tabelë shohim se në mostrën e nxënësve ka edhe nxënës të moshës 6 vjeç, por ata janë nxënës të rregullt të klasës së dytë.

Nxënësit e përfshirë në hulumtim ishin nxënës të klasave 1-5 të arsimit fillor, ku prej tyre 46 ose 18.2% ishin nxënës të klasës së dytë, 57 ose 22.5% ishin nxënës të klasës së tretë, 63 ose 24.9% ishin nxënës të klasës së katërtë dhe 87 ose 34.4% ishin nxënës të klasës së pestë.

Grafiku 3. Mostra e nxënësve sipas klasave



Numri më i madh i nxënësve të përfshirë në hulumtim janë nxënës të klasave të katërta dhe të pesta, ndërsa mosha mesatare e tyre është mosha 9 vjeç.

2.4. Instrumentet e hulumtimit

Për realizimin e suksesshëm të hulumtimit në terren ka qenë e domosdoshme që të përgatisim instrumentet për hulumtim. Të dhënat i kemi mbledhur përmes pyetësorëve. Përmes pyetësorëve morëm informacione nga nxënësit, mësimitdhënësit dhe drejtorët e shkollave për mënyrën e funksionimit të mësimit zgjedhor në arsimin fillor. Për mbledhjen e të dhënave jemi shërbyer me tri lloje të pyetësorëve:

1. Pyetësor për drejtorë të shkollave fillore
2. Pyetësor për mësimitdhënësit, dhe
3. Pyetësor për nxënës

Pyetësorët janë strukturuar në dy blloqe:

- ❖ Të dhëna të përgjithshme - të dhënat personale të respondentëve,

- ❖ Të dhëna lidhur me hulumtimin- të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjen, planifikimin dhe organizimin e mësimit zgjedhor.

Shumica e pyetjeve në të tre pyetësorët ishin të kombinuara me të cilat kërkohet që, përveç përgjigjes së sugjeruar, të jepet edhe mendimi i drejtorit, nxënësit apo mësimitdhënësit. Kishte pyetje të hapura në të cilat respondentët kishin mundësinë të shprehnin lirshëm mendimet e tyre si dhe pyetje të mbyllura, me përgjigje të sugjeruara (të tipit Likert).

2.5. Procedura e mbledhjes së të dhënave

Gjatë mbledhjes së të dhënave për hulumtimin kemi kaluar në disa procedura. Fillimisht, në dy shkolla është bërë pilotimi i instrumenteve të hulumtimit. Pasi që jemi siguruar që instrumentet janë të përshtatshme për hulumtim, kemi kontaktuar me Drejtoritë komunale të Arsimit në komunat ku e kemi shtri hulumtimin. Nga Drejtoria Komunale e Arsimit është kërkuar leje dhe të caktohen dy shkolla ku mund të shtrihej hulumtimi. Drejtoria Komunale e Arsimit ka ndihmuar në kontaktet me shkollat, me të cilat bashkërisht kemi caktuar oraret e mundshme për të realizuar hulumtimin. Bashkërisht me drejtorin e shkollës dhe me mësimitdhënësit kemi biseduar dhe jemi dakorduar që në hulumtim t'i përfshijmë nga pesë nxënës për klasat e para, të dyta, të treta, të katërta dhe të pesta dhe mësimitdhënësit e arsimit fillor.

Administrimi i pyetësorëve brenda një shkolle është bërë në të njëjtën kohë, në salla të ndryshme. Koha për plotësimin e fletë pyetësorëve nuk ka qenë e limituar. Para fillimit dhe gjatë gjithë procesit janë dhënë instruksionet e nevojshme për plotësimin e pyetësorëve.

Gjithsesi është përfillur edhe aspekti etik. Nga drejtori i shkollës është kërkuar që të njoftojë me kohë mësime të tjerë dhe të marrin leje nga prindërit për nxënësit të cilët do të jenë pjesë e hulumtimit.

2.6. Procedura e analizimit të të dhënave

Përpunimi i të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve u realizua në dy forma:

- përmes programit kompjuterik SPSS-16 (Statistical Package for the Social Sciences - Pakoja Statistike për Shkencat Shoqërore). Fillimisht kemi bërë kodimin e të dhënave dhe krijimin e variablave. Më pas këto të dhëna janë vendosur në programin SPSS dhe kemi bërë analizën e tyre varësisht prej nevojës.
- përmes metodës së analizës, duke kategorizuar përgjigjet e dhëna nga pyetjet e hapura, për analizën e të cilave kemi krijuar modele të caktuara.

Për secilën pyetje kemi analizuar përgjigjet e respondentëve ndaras, pastaj është bërë krahasimi mes përgjigjeve të tyre në pyetjet që kishin të bëjnë me të njëjtën problematikë.


III. REZULTATET E HULUMTIMIT

Për mbledhjen e të dhënave jemi shërbyer me tri lloje të pyetësorëve: Pyetësor për drejtor, për mësimdhënës dhe pyetësor për nxënës. Në pyetësorin për drejtor dhe mësimdhënës kemi parashtruar pyetje të njëjta me qëllim që të bëjmë krahasime mes përgjigjeve të dhëna. Po ashtu, edhe pyetjet e parashtruara në pyetësorin për nxënës janë parashtruar në një formë ndryshe por që kanë qëllime të njëjta me pyetjet e mësimdhënësve dhe drejtorëve. Me pyetjet e parashtruara në pyetësorin për drejtor, nxënës dhe mësimdhënës, është synuar të arrijmë në informacionet kryesore që kanë të bëjnë me realizimin e Kurrikulës Zgjedhore të përcaktuar nga vet shkolla. Të dhënat e grumbulluara nga pyetësorët do t'i paraqesim në tabela dhe me grafik.

3.1. Përkufizimi i mësimi zgjedhor

Përkufizimi i drejtë dhe kuptimi i qëllimit të mësimi zgjedhor ndihmon në përzgjedhjen dhe realizimin e suksesshëm të lëndës apo kursit. Pyetja e parë për drejtorë dhe mësimdhënës ka të bëjë me statusin e lëndës zgjedhore në shkollë dhe me kuptimin e përkufizimit të tij si lëndë me zgjedhje. Në pyetjen e parashtruar se *Çfarë është mësimi zgjedhor?*- janë paraqitur tri opsione të mundshme, nga të cilat do zgjedhin njërin dhe do japin arsyetimin e tyre për opsionin e zgjedhur.


Grafiku 4. Statusi i lëndës zgjedhore sipas drejtorëve



Në grafikun 4 shohim se 54.5% e drejtorëve të shkollave pohojnë se lënda zgjedhore është lëndë me zgjedhje të lirë e cila në momentin që zgjidhet merr statusin e lëndës së rregullt, 36.4% prej tyre pohojnë se është lëndë me zgjedhje të lirë, ndërsa 9.1% mendojnë se është lëndë e obligueshme.


Opinionet e drejtorëve të shkollave janë ndryshe nga ato të mësimdhënësve.

Sipas të dhënave të mbledhura kuptojmë se, 82% e mësimdhënësve lëndën zgjedhore e shohin si lëndë me zgjedhje të lirë, 8.2% e shohin si lëndë të obligueshme, 8.2% e mësimdhënësve nuk japin përgjigje, ndërsa vetëm 1.5% pohojnë se është lëndë zgjedhore e cila në momentin që zgjidhet merr statusin e lëndës së rregullt.



Grafiku 5. Statusi i lëndës zgjedhore sipas mësimdhënësve

Mes përgjigjeve të drejtorëve dhe mësimitdhënësve kemi dallime të theksuara. Nëse bëjmë një dallim mes përgjigjeve të drejtorëve dhe mësimitdhënësve del se:



Grafiku 6. Dallimet mes opinionëve të drejtorëve dhe mësimitdhënësve për statusin e lëndës zgjedhore

Nga paraqitja grafike shohim se numri më i madh i drejtorëve e kuptojnë drejt statusin e lëndës zgjedhore në shkollë, ku 54.5% prej tyre kanë dhënë përgjigje se lënda zgjedhore është lëndë me zgjedhje të lirë, e cila në momentin që zgjidhet merr statusin e lëndës së rregullt. Të njëjtin mendim e kanë vetëm 1.6% e mësimitdhënësve. Arsyetimet e drejtorëve për këtë përgjigje janë se lënda zgjedhore pasi të zgjidhet merr statusin e lëndës së rregullt sepse bëhet e obligueshme për nxënësit, vlerësohet dhe realizohet në bazë të planit dhe programit. Nga mësimitdhënësit nuk kemi ndonjë arsyetim për këtë përgjigje.

Numri më i madh i mësimitdhënësve mendojnë se lënda zgjedhore është lëndë me zgjedhje të lirë, ku përgjigje të tillë kanë dhënë 82% e mësimitdhënësve të përfshirë në hulumtim ndërsa nga drejtorët kemi 36.4%.

Nga analiza e përgjigjeve të dhëna nga drejtorët dhe nga mësime të shprehura shohim se mësimi zgjedhor si lëndë me zgjedhje të lirë kuptohet në dy variante:

- *Zgjedhje e lirë e mësimeve*, sepse mësime të shprehura e zgjedhin lëndën për të cilën mendojnë se nxënësit kanë më shumë nevojë, aty ku vërejnë se nxënësit kanë më shumë nevojë dhe orët apo lëndët e mësimit zgjedhor i shfrytëzojnë për plotësimin e njohurive të nxënësve në lëndët që mbesin mbraza në mësime.

- *Zgjedhje e lirë e nxënësve* sepse në marrëveshje me prindërit dhe në bashkëpunim me mësime të shprehura vet nxënësit e zgjedhin lëndën zgjedhore në bazë mundësive, të talentit- prires që kanë, duke zgjedhur lëndë të ndryshme që dallojnë nga lëndët e obligueshme.

Drejtorët e shohin si lëndë me zgjedhje të lirë nga mësime të shprehura, sepse mësime të shprehura e zgjedh lëndën që i nevojitet më së shumti, para ose në fillim të vitit shkollor.

Afërsisht në përqindje të njëjtë janë përgjigjet e dhëna nga drejtorët dhe mësime të shprehura të cilët mendojnë se lënda zgjedhore është lëndë e obligueshme, ku 9.1% e drejtorëve kanë dhënë përgjigje të tillë, ndërsa nga mësime të shprehura 8.2% kanë këtë mendim.

Drejtorët nuk kanë dhënë ndonjë arsye për përgjigjen e dhënë ndërsa mësime të shprehura kanë arsye duke thënë se mësimi zgjedhor si lëndë e obligueshme organizohet dy orë në javë, ndërsa zgjedhja i mbetet mësime të shprehura për materialin e mundshëm që duhet realizuar dhe meriton vendin e duhur në shkollë. Sipas tyre, nxënësit duhet të orientohen në ato lëndë që janë më të rëndësishme për ta, sidomos në lëndët Gjuhë Shqipe dhe Matematikë.


Disa nga mësime të mësimdhënësve, 8.2% prej tyre, nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje. Nga arsyetimet e dhëna kuptojmë se lënda zgjedhore sipas tyre nuk ka statusin e lëndës së obligueshme e as lëndë me zgjedhje të lirë. Sipas tyre, duhet të sqarohet më drejt kjo lëndë, ngase nuk po realizohet si zgjedhje e lirë e nxënësve por aktivitetet profesionale/ e klasave vendosin vet cilën lëndë e shohin të arsyeshme ta marrin, dhe zakonisht orët e mësimit zgjedhor shfrytëzohen për plotësim të njohurive të nxënësve nga lëndët e obligueshme, pra si mësim plotësues.

“Lënda zgjedhore në një mënyrë është imponuese sepse më tepër po bëhet për të mbuluar dhe krijuar fond të orëve për mësime të mësimdhënësve, e jo për të përmbushur kërkesat, nevojat dhe dhuntitë e nxënësve”- shprehet një drejtor shkolle.

Nuk ka dallime në përgjigjet e dhëna mes mësime të mësimdhënësve dhe mësime të mësimdhënësveve. 82 % e mësime të mësimdhënësveve pohojnë se lënda zgjedhore është lëndë me zgjedhje të lirë ndërsa një gjë të tillë e pohojnë 100% e mësime të mësimdhënësve. Si mësime të mësimdhënësve, lëndën zgjedhore e definojnë si lëndë me zgjedhje të lirë.

3.2. Arsyeya për organizimin e mësimit zgjedhor

Nga drejtorët e shkollave dhe mësime të mësimdhënësive kemi kërkuar arsyet pse organizohet mësimi zgjedhor. Në pyetjen: *Cila është arsyeja për organizimin e mësimit zgjedhor në shkollën tuaj?*- kemi marrë përgjigje të ndryshme:




Grafiku 7. Arsyeya e organizimit të mësimit zgjedhor sipas drejtorëve

Në grafikun 7 shohim se 50% e drejtorëve mendojnë se arsyeja pse organizohet mësimi zgjedhor në shkollën e tyre është plotësimi i njohurive të nxënësve me ngecje në mësim. Zgjedhjen e moduleve të ndryshme, si arsye për organizimin e mësimit zgjedhor e shohin 37.5% e drejtorëve, ndërsa 12.5% e drejtorëve mendojnë se arsye për organizimin e mësimit zgjedhor është që nxënësve tu ofrohen përmbajtje shtesë sipas nevojës së tyre.

Edhe mësime të mësimdhënësive paraqesin arsye të ndryshme për organizimin e mësimit zgjedhor në arsimin fillor. Përveç arsyeve të cilat i kemi paraqitur në pyetësor, mësime të mësimdhënësive potencojnë edhe arsye tjera.

Shumica e mësime të mësimdhënësive, ose 45.9%, pohojnë se arsyeja për organizimin e mësimit zgjedhor është zgjedhja e moduleve të ndryshme të cilat zgjidhen në bazë të dëshirës, dhuntisë, nevojës

apo interesit të nxënësve, 23% si arsye potencojnë plotësimin e njohurive të nxënësve që kanë ngecje në mësim, 13.1% mendojnë se zgjedhja e përmbajtjeve shtesë për nxënësit që kanë nevojë është arsye për organizimin e mësimit zgjedhor në shkollë. Po ashtu, 13.1% e mësimeve japin arsye tjera për organizimin e mësimit zgjedhor, si: organizimin e aktiviteteve atraktive për nxënës dhe organizimin e mësimit plotësues.



Grafiku 8. Arsyja e organizimit të mësimit zgjedhor sipas mësimeve

4.9% të mësimeve nuk japin ndonjë arsye për organizimin e mësimit zgjedhor në shkollën e tyre, pra nuk kanë dhënë përgjigje fare.

Nga paraqitjet grafike shohim se numri më i madh i drejtorëve të përfshirë në hulumtim mendojnë se arsyeja për organizimin e mësimit zgjedhor në shkollën e tyre është plotësimi i njohurive të nxënësve që mbesin mbrapa me mësim, ndërsa numri më i madh i mësimeve mendojnë se arsyeja për organizimin e mësimit zgjedhor në arsimin fillor është që nxënësit të zgjedhin module të ndryshme sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit të tyre.

3.3. Funkcionimi i mësimit zgjedhor

Për të kuptuar se si funksionon mësimi zgjedhor në arsimin fillor, ne kemi parashtruar pyetjen: *Nga aspekti ligjor, si e rregullon shkolla funksionimin e mësimit zgjedhor?* Nga drejtorët dhe mësime të tjerë të përfshirë në hulumtim kemi marrë këto përgjigje:

Tabela 5. Funkcionimi i mësimit zgjedhor

Kriteri	Drejtorët e shkollave		Mësime të tjerë	
	Nr	%	Nr	%
Në bazë të Udhëzimit Administrativ	5	45.5	6	9.84
Në bazë të Planeve dhe Programeve Zyrtare	3	27.3	17	27.9
Në bazë të Rregulloreve brendshme të shkollës	3	27.3	12	19.7
Tjetër	-	-	26	42.62

Në tabelën 5 shohim se opinionet e drejtorëve dhe mësime të tjerë të përfshirë në hulumtim janë të ndryshme. Numri më i madh i drejtorëve, 45.5% prej tyre, shprehen se mësimin zgjedhor në shkollën e tyre e organizojnë në bazë të Udhëzimit Administrativ: organizimi i mësimit zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar Nr: MASHT [I] 1/2005 Datë:06.01.2005, ndërsa nga numri i përgjithshëm i mësime të tjerë të përfshirë në hulumtim, vetëm 9.84% prej tyre janë shprehur se mësimin zgjedhor e organizojnë në bazë të këtij udhëzimi.


Numri më i madh i mësimdhënësve pohojnë se nuk janë të informuar fare as me ligj e as me rregulla dhe mësimin zgjedhor e rregullojnë në forma të ndryshme, në baza individuale të mësimdhënësve, në bazë të teksteve që posedojnë, në bashkëpunim me mësimdhënësit e tjerë apo zgjedhin lëndë për të cilat nxënësit kanë më shumë nevojë.

Në tabelën paraprake, nga përgjigjet e marra nga drejtorët dhe mësimdhënësit shohim se kemi mendime të ndryshme. Për të parë se a ka harmoni mes stafit udhëheqës të shkollës dhe personelit mësimor brenda shkollës, kemi krahasuar përgjigjet e dhëna nga drejtorët dhe mësimdhënësit e shkollës së njëjtë.

Për ti krahasuar më lehtë, përgjigjet e mësimdhënësve i kemi grupuar në tri grupe:

- I. Përgjigjet e mësimdhënësve të shkollave drejtorët e të cilave kanë dhënë përgjigje se mësimin zgjedhor shkolla e rregullon në bazë të Udhëzimit Administrativ,
- II. Përgjigjet e mësimdhënësve të shkollave drejtorët e të cilave kanë dhënë përgjigje se mësimin zgjedhor shkolla e rregullon në bazë të Planeve dhe Programeve zyrtare,
- III. Përgjigjet e mësimdhënësve të shkollave drejtorët e të cilave kanë dhënë përgjigje se mësimin zgjedhor shkolla e rregullon në bazë rregulloreve të brendshme të shkollës.

Në të tri grupet, përgjigjet e marra nga mësimdhënësit nuk përputhen me mendimet e drejtorit të shkollës së tyre. Për të parë më mirë dallimet, i paraqesim në grafikun 9.



Grafiku 9. Dallimet mes përgjigjeve të dhëna nga drejtorët dhe mësimdhënësit rreth funksionimit të mësimin zgjedhor

Në grafikun 9 shohim dallime të mëdha në mes të përgjigjeve të dhëna nga drejtorët dhe mësimdhënësit e shkollave. Në grupin e parë, ku drejtorët kanë dhënë përgjigje se funksionimin e mësimin zgjedhor shkolla e rregullon në bazë të Udhëzimit Administrativ, vetëm 12.29% e mësimdhënësve e pohojnë këtë. Shumica e mësimdhënësve nuk e kanë këtë informacion, ngase 85.72% e mësimdhënësve pohojnë se funksionimin e mësimin zgjedhor shkolla e rregullon në bazë të Planeve dhe Programeve Zyrtare si dhe rregulloreve të brendshme të shkollës. Dallimi mes përgjigjeve të dhëna është shumë i madh.

Në grupin e dytë ku hyjnë mësimdhënësit e shkollave, drejtorët e të cilave pohojnë se funksionimin e mësimin zgjedhor e rregullojnë në bazë të Planeve dhe Programeve Zyrtare. Vetëm 31.25% e mësimdhënësve e ndajnë të njëjtin mendim, që do të thotë se kemi dallim shumë të madh në opinionet e tyre. Ndërsa, 68.75% e mësimdhënësve pohojnë se funksionimin e mësimin zgjedhor shkolla e rregullon në bazë të

Udhëzimit administrativ, Rregulloreve të brendshme të shkollës dhe baza individuale të mësimit dhe mësuesve.

Në grupin e tretë përfshihen mësuesit dhe mësueset e shkollave të cilave drejtorët pohojnë se funksionimi i mësimit zgjedhor rregullohet në bazë të rregulloreve të brendshme të shkollës.

Në mes të pyetjeve të drejtorëve dhe mësimit dhe mësuesve kemi shumë dallim ngase vetëm 7.14% e mësimit dhe mësuesve e pohojnë të njëjtën gjë, ndërsa 92.86 e mësimit dhe mësuesve pohojnë se funksionimin e mësimit zgjedhor shkolla e rregullon në bazë të Udhëzimit Administrativ, Planeve dhe programeve Zyrtare dhe në forma të tjera, si: në baza individuale, në bazë të teksteve që posedojnë, në pajtim me mësimit dhe mësuesit e tjerë të aktivitetit, etj.

Nga përgjigjet e drejtorëve dhe mësimit dhe mësuesve të të njëjtës shkollë, shohim se kemi opinione të ndryshme sa i përket bazës normative për funksionimin e Kurrikulës Zgjedhore në shkollë.

3.4. Zgjedhja e mësimit dhe mësuesit të mësimit zgjedhor

Në shkollën tuaj, a bëhet konkurs i veçantë për përzgjedhjen e mësimit dhe mësuesit për lëndën zgjedhore? Kjo pyetje u është bërë për drejtorët e shkollave dhe mësimit dhe mësuesit e përfshirë në hulumtim. Për këtë pyetje janë dhënë këto përgjigje:

Tabela 6. Përzgjedhja e mësimit dhe mësuesit për lëndën zgjedhore

Përgjigjet	Drejtorët	Mësimit dhe mësuesit
Po	-	23 %
Jo	100 %	77 %

Nga paraqitja tabelare shihet se të gjithë drejtorët e shkollave, pra 100% e drejtorëve të përfshirë në hulumtim pohojnë se përzgjedhja e mësimit dhe mësuesit të lëndës zgjedhore nuk bëhet me konkurs. Të njëjtin mendim e ndajnë edhe 77% e mësimit dhe mësuesve, ndërsa 23% e mësimit dhe mësuesve pohojnë se

pranimi i mësimeve për lëndën zgjedhore bëhet me konkurs të veçantë.

Në përgjithësi, nga përgjigjet e drejtorëve dhe mësimeve mund të përfundojmë se nuk bëhet konkurs i veçantë për përzgjedhjen e mësimeve për lëndën e mësimit zgjedhor. Pasi që nuk bëhet konkurs i veçantë, për të kuptuar se si zgjidhet mësimeve i lëndës së mësimit zgjedhor, kemi parashtruar pyetjen shtesë: *Nëse jo, si zgjidhet mësimeve i lëndës së mësimit zgjedhor?*

Në këtë pyetje nga drejtorët e pëfshirë në hulumtim janë dhënë këto përgjigje:

- Mësimeve i lëndës zgjedhore zgjidhet në bazë të planit që ofron,

- Orët e mësimit zgjedhor në arsimin fillor në të shumtën e rasteve i mban mësimeve i klasës, ndërsa në Arsimin e Mesëm të Ulët, orët e mësimit zgjedhor u jepen mësimeve të cilët nuk e kanë normën e plotë, pra bëhet plotësimi i orëve.

Shumica e mësimeve nuk janë të njoftuar me mënyrën e përzgjedhjes së mësimeve të lëndës zgjedhore. Në të shumtën e rasteve orët e mësimit zgjedhor i mbajnë mësimeve të klasave, por ka raste kur këto orë i mban mësimeve tjetër, që ka përgatitje të përafërt me lëndën që e kërkojnë nxënësit dhe është caktuar më qëllim të plotësimi të orëve (plotësimi i orëve).

Për të kuptuar se, në realitet, a ka mësimeve të veçantë për lëndën zgjedhore, kemi parashtruar pyetjen:

Cili është për momentin mësimeve i lëndës zgjedhore?

Tabela 7. Mësimdhënësit e lëndës zgjedhore

Mësimdhënësi i klasës	60%
Mësimdhënësi i veçantë	20%
Tjetër	20%

Në tabelën 7 shohim se, 60% e drejtorëve të shkollave shprehen se orët e mësimi zgjedhor i mban mësimdhënësi i klasës. Se për lëndën zgjedhore është mësimdhënësi i veçantë, këtë e pohojnë 20% e drejtorëve, të shkollave, ndërsa pjesa tjetër e drejtorëve, 20% prej tyre, pohojnë se për momentin orët e mësimi zgjedhor i mbajnë mësimdhënësit të cilët kanë mungesë të fondit të orëve, dhe atij iu kanë dhënë këto orë me qëllim të plotësimit të normës.


Në përgjigjet e mësimdhënësve nuk vërejmë ndonjë dallim të theksuar nga ato të drejtorëve.

Tabela 8. Mësimdhënësit e lëndës zgjedhore

Mësimdhënësi i klasës	82%
Mësimdhënësi i veçantë	4.9%
Tjetër	13.1%

Në tabelën 8 shihet se, 82% e mësimdhënësve pohojnë se për momentin mësimdhënës i lëndës zgjedhore është mësimdhënësi i klasës, 4.9% e mësimdhënësve pohojnë se është mësimdhënës i veçantë, ndërsa 13.1% mendojnë se orët e lëndës zgjedhore i mban mësimdhënësi lëndor që ka njohuri paraprake apo ka afërsisht lëndën e njëjtë dhe ka mbet pa fond të orëve.

Grafiku 10. Mësimdhënësit e lëndës zgjedhore



Në paraqitjen grafike shihet se mësimdhënësit e lëndës zgjedhore në arsimin fillor në të shumtën e rasteve janë mësimdhënësit e klasës. Këtë e vërtetojmë me përgjigjet e drejtorëve dhe mësimdhënëseve, ku 60% e drejtorëve dhe 82% e mësimdhënëseve pohojnë se mësimdhënësit e lëndëve zgjedhore në arsimin fillor janë mësimdhënësit e klasave. 20% e drejtorëve dhe 4.9% e mësimdhënëseve pohojnë se caktohen (zgjedhen) mësimdhënësit të veçantë për lëndët zgjedhore, ndërsa 20% e drejtorëve dhe 13.1% e mësimdhënëseve të përfshirë në hulumtim pohojnë se mësimdhënësit për lëndën zgjedhore caktohen në një mënyrë tjetër, ku sipas të dhënave që kemi marr nga respondentët mund të jetë mësimdhënësi lëndor i cili ka njohuri paraprake, mësimdhënësi që ka mbet pa normë të plotë, etj.

3.5. Përzgjedhja e lëndës së mësimi zgjedhor


Lidhur me përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore kemi parashtruar disa pyetje për drejtorë, mësime dhe nxënës. Meqenëse lëndën zgjedhore nxënësit duhet ta zgjedhin sipas dëshirës, dhuntisë dhe interesave të tyre, mendojmë se lënda zgjedhore duhet të jetë lënda me e dashur për ta. Për të parë se ku qëndron lënda zgjedhore në mesin e lëndëve tjera dhe sa atraktive është ajo për nxënësit, kemi parashtruar pyetjen: *Cila lëndë mësimore ju pëlqen më shumë?*

Tabela 9. Lëndët që nxënësve u pëlqejnë më shumë

Nr	Lëndët mësimore	Frekuenca	%
1	Matematika	123	49.2
2	Gjuhë Shqipe	33	13.2
3	Histori	27	10.8
4	Gjuha Angleze	14	5.60
5	Mësim zgjedhor (Edukatë shoqërore, Ekologjia dhe mjedisi, Edukatë shëndetësore)	13	5.13
5	Njeriu dhe natyra	11	4.4
6	Edukatë qytetare	9	3.6
7	Edukatë figurative	9	3.6
8	Edukatë fizike	8	3.2
9	Edukatë muzikore	2	0.8

Nga 49.2% e nxënësve janë marrë përgjigje se lënda që ju pëlqen më shumë është Matematika, 13.2% e nxënësve pëlqejnë lëndën e Gjuhës Shqipe, 10.8% pëlqejnë lëndën e Historisë dhe 5.60% e nxënësve pëlqejnë lëndën e Gjuhës Angleze.

Grafiku 11. Dallimet mes nxënësve dhe nxënësve në lëndët që pëlqejnë më shumë



Në grafiku 11 shihet se kemi dallime të vogla në opinionet e nxënësve sa i përket gjinisë. Si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat lënda më e pëlqyer del të jetë lënda e Matematikës. Lëndët e mësimi zgjedhor, radhiten në mesin e pesë lëndëve që nxënësve ju pëlqejnë më shumë. Nga lëndët zgjedhore veçohen Edukata Qytetare, Ekologjia dhe Mjedisi, si dhe Edukata Shëndetësore.

Më pak të pëlqyera radhiten edhe lëndët tjera të mësimi të rregullt, si: Njeriu dhe natyra, Edukata qytetare, Edukata fizike dhe Edukata muzikore.

Por, *Si bëhet përzgjedhja e lëndës zgjedhore?* Kjo pyetje u është parashtruar drejtorëve dhe mësimitdhënësve.

Tabela 10. Përzgjedhja e lëndës zgjedhore


	Drejtorët	Mësimitdhënësit
Sugjerohet nga MASHT	27.3	37.7
Sugjerohet nga DKA	9.1	26.2
Në bazë të kërkesës së nxënësve	45.5	1.6
Në bazë të kërkesës së prindërve	18.2	8.2
Në bazë të kërkesës së komunitetit	-	21.3
Tjetër	-	4.9

Nga paraqitja tabelare shihet se 45.5% e drejtorëve të shkollave pohojnë se lëndët zgjedhore zgjedhen në bazë të kërkesës së nxënësve, ndërsa një gjë të tillë e pohojnë vetëm 1.6% e mësimitdhënësve. Numri më i madh i mësimitdhënësve, 37.7% prej tyre pohojnë se lënda e mësimit zgjedhor sugjerohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa një gjë të tillë e pohojnë 27.3% e drejtorëve të shkollave. Shihet se 4.9% e mësimitdhënësve kanë një përgjigje tjetër për mënyrën se si e bëjnë përzgjedhjen e lëndës zgjedhore. Sipas tyre, lëndën zgjedhore e zgjedhin mësimitdhënësit e aktivitetit të klasave, e që 9.9% prej mësimitdhënësve që kanë përgjigje tjetër pohojnë se nuk dinë për mënyrën se si zgjidhet kjo lëndë ndërsa pjesa tjetër, 90.1% e mësimitdhënësve që kanë një përgjigje tjetër, pohojnë se orët e mësimit zgjedhor i shfrytëzojnë për mësimit plotësues nga lëndët e obligueshme.

Pyetjen: *Nga cilat lëndë bëhet përzgjedhja e mësimit zgjedhor?*- e kemi parashtruar për mësime të zgjedhura ku 68.9% e prej tyre pohojnë se përzgjedhja e mësimit zgjedhor bëhet nga lëndët e obligueshme, ndërsa 31.1% pohojnë se zgjedhin lëndë apo kurse të reja.

Për të parë se sa marrin pjesë nxënësit në zgjedhjen e lëndës zgjedhore, për nxënësit e përfshirë në hulumtim kemi parashtruar edhe pyetjen: *Për mësimin zgjedhor, cilën lëndë e mësoni këtë vit shkollor?*

Në këtë pyetje kemi marrë përgjigje se lëndët që përzgjidhen për mësimin zgjedhor në klasën e dytë, tretë dhe të katërtë afërsisht janë të njëjtat lëndë ndërsa në listën e lëndëve zgjedhore që mësohen në klasën e pestë shohim se ka edhe lëndë të reja.



Nga grafiku 12 shihet se në klasën e dytë, të tretë dhe të katërtë lënda që mësohet më shumë si lëndë zgjedhore është Edukate Shoqërore, ndërsa në klasën e pestë dominon lënda Ekologjia dhe mjedisi, ku 60% e nxënësve të klasës së pestë kanë pohuar se si lëndë zgjedhore këtë vit e mësojnë këtë lëndë. Edhe lënda e Matematikës dhe lënda e Gjuhës Shqipe, të cilat janë edhe si lëndë të obligueshme, mësohen edhe si lëndë zgjedhore në të

gjitha klasat. Se, Matematika është edhe në listën e lëndëve zgjedhore, këtë e pohojnë 8% e nxënësve të klasës së dytë, 9% e nxënësve të klasës së tretë, 17% e nxënësve të klasës së katërtë dhe 15% e nxënësve të klasës së pestë, që do të thotë se në klasat e larta të arsimit fillor Matematika është më e pranishme si lëndë zgjedhore. Nuk është vetëm Matematika nga lëndët e obligueshme e cila hyn në listën e lëndëve zgjedhore. Të njëjtën situatë e kemi edhe me lëndën e Gjuhës Shqipe, për të 2% e nxënësve të klasës së dytë, 2% e nxënësve të klasës së tretë, 8% e nxënësve të klasës së katërtë dhe 5% e nxënësve të klasës së pestë pohojnë se e mësojnë edhe si lëndë zgjedhore.


Në pyetjen: *Kush e ka zgjedhur lëndën e mësimin zgjedhor?*- nga nxënësit kemi marrë këto përgjigje:

Tabela 11. *Kush e zgjedh lëndën zgjedhore?*

	Nxënësit	Mësimdhënësi	Drejtori	Nuk e di	Pa përgjigje
Nr	28	97	42	81	5
%	11.1	38.3	16.6	32.0	2.0

Nga tabelën 11 shihet se 38.3% e nxënësve pohojnë se lëndën zgjedhore e zgjedh mësimdhënësi, 32% e nxënësve nuk e dijnë se kush e zgjedh lëndën zgjedhore, 16.6% mendojnë se e zgjedh drejtori i shkollës, 11.1% pohojnë se e zgjedhin vet nxënësit, ndërsa 2% prej tyre nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje. Nga përgjigjet e tyre shohim se nxënësit nuk e kanë informacionin e duhur se kush duhet ta zgjedh e as kush e zgjedh në realitet lëndën zgjedhore.

Pyetja në vazhdim për nxënësit është: *A ju pyesin juve se cilën lëndë doni ta mësoni si lëndë zgjedhore?*



Grafiku 13. A pyeten nxënësit për lëndën zgjedhore që duan ta mësojnë?

Në grafikun 13 shihet se 43.1% e nxënësve pohojnë se asnjëherë nuk i pyesin për lëndën që do të zgjedhin, 34.4% pohojnë se i pyesin nganjëherë, ndërsa 21.5% pohojnë se gjithëherë i pyesin se cilën lëndë duan ta mësojnë si lëndë zgjedhore. Nga përgjigjet e nxënësve mësuam se shumë pak pyeten nxënësit për lëndën që do ta mësojnë si lëndë me zgjedhje.

Por: *A ju pëlqen lënda e mësimi zgjedhor?*

Nga nxënësit e përfshirë në hulumtim del se 81.6% e tyre e pëlqejnë shumë lëndën e mësimi zgjedhor. Nuk kemi dallime as në përgjigjet e tyre në mes të nxënësve meshkuj dhe femra.

Tabela 12. A ju pëlqen lënda e mësimi zgjedhor?


Gjinia	Shumë	Mesatarisht	Pak	Aspak
Femra	84.6	15.4	-	-
meshkuj	74.0	20.8	5.2	-

Në tabelë shihet se 84.6% të nxënësve (femrave) u pëlqen shumë lënda zgjedhore ndërsa 15.4% prej tyre u pëlqen mesatarisht kjo lëndë. Ndërsa 74 % e meshkujve pohojnë le lënda zgjedhore u pëlqen shumë, 20.8% u pëlqen mesatarisht,

ndërsa vetëm 5.2% prej tyre pohojnë se kjo lëndë iu pëlqen pak. Por, a do ta ndërronin këtë lëndë me ndonjë tjetër?

Shumica e nxënësve, 72.2% prej tyre pohojnë se edhe po të ju jepet mundësia nuk do ta ndërronin lëndën e mësimit zgjedhor me ndonjë lëndë tjetër, ndërsa 27.8% pohojnë se po të ju jepet mundësia do ta ndërronin këtë lëndë me lëndët tjera si: Matematikë, Edukatë qytetare, Ekologjia dhe mjedisi, Edukatë shëndetësore, Histori, etj.

Cila lëndë zgjedhore është më prezente në shkollën tuaj?-Këtë pyetje u kemi parashtruar drejtorëve dhe mësimitdhënësve të përfshirë në hulumtim.




Grafiku14. Lënda zgjedhore më e pranishme në shkollë sipas mësimitdhënësve

Në grafikun 14 shohim se, kemi disa lëndë të cilat janë përfshirë në listën e lëndëve zgjedhore. Lënda e Edukatës qytetare sipas mësimitdhënësve është më shumë e pranishme si lëndë zgjedhore. Këtë e pohojnë 47.5% e mësimitdhënësve, 16.4% e mësimitdhënësve pohojnë se lënda më prezente në shkollën e tyre është Mbrojtja e mjedisit jetësor, 14.8% pohojnë se është lënda Të drejtat dhe liritë e njeriut, 10.4% thonë Matematika, 6.36 Gjuha Shqipe, 3.3% kurse

Shëndetësore, ndërsa 1.6% pohojnë se lënda më e pranishme si lëndë zgjedhore në shkollën e tyre është Ekologjia dhe Mjedisi. Drejtorët e shkollave cekin katër lëndë të cilat sipas tyre janë lëndët më të pranishme në shkollë si lëndë zgjedhore. Sipas drejtorëve, lënda e Edukimit Qytetar është lënda më e pranishme si lëndë zgjedhore. Këtë e pohojnë 33.5% e drejtorëve. Po ashtu 33.5% pohojnë se është Të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, 22% pohojnë se është lënda Mbrojtja e Mjedisit, ndërsa 11% e drejtorëve pohojnë se lënda Kurse Shëndetësore është lënda më e pranishme si lëndë zgjedhore në shkollën e tyre.

Grafiku 15. Lëndët zgjedhore më të pranishme



Siç pamë nga përgjigjet e dhëna nga drejtorët dhe mësuesit lëndët zgjedhore që janë më të pranishme në shkollën e tyre janë: Edukimi qytetar, Të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, Mbrojtja e Mjedisit jetësor, Kurse shëndetësore, Ekologjia dhe Mjedisi, lëndë këto të cilat janë të sugjeruara në planet dhe programet mësimore zyrtare.

Tabela 13. Lëndët zgjedhore më të pranishme në shkollën fillore

Lëndët	Drejtorët	Mësimdhënësit
Edukim qytetar	33.5 %	47.5 %
Kurse shëndetësore	11 %	3.3 %
Të drejtat dhe Liritë e Njeriut	33.5%	14.8 %
Mbrojtja e Mjedisit Jetësor	22 %	16.4 %
Ekologjia dhe Mjedisi	-	1.6 %
Gjuhë Shqipe	-	6.36 %
Matematikë	-	10.04 %


Në tabelën 13 shihet se lënda e Edukimit Qytetar më së shpeshti zgjidhet si lëndë zgjedhore. Këtë e kanë pohuar edhe drejtorët dhe mësimdhënësit e arsimit fillor. Në përgjigjet e mësimdhënësve përveç lëndëve të cilat janë të sugjeruara në Planet dhe Programet mësimore zyrtare, kemi edhe lëndë të reja të cilat janë sugjeruar nga nxënësit, prindërit apo mësimdhënësit, si: Enciklopedi për fëmijë dhe Edukatë Shoqërore.

Dallimi qëndron në lëndët e obligueshme, ku nga tabela shohim se drejtorët nuk e cekin se Gjuha Shqipe dhe Matematika janë në grupin e lëndëve zgjedhore ndërsa nga mësimdhënësit kuptojmë se këto lëndë janë bukur shumë të pranishme edhe si lëndë zgjedhore. Siç shihet në tabelë, nuk është i vogël numri i mësimdhënësve të cilët pohojnë se lënda e Matematikës është edhe në listën e lëndës zgjedhore. Këto dy lëndë zgjidhen me qëllim të ofrimit të mësimi plotësues. Sipas mësimdhënësve programet e të dy lëndëve janë shumë të ngarkuara, nxënësit mbesin mbrapa në mësimet, dhe për të

krijuar mundësi që përmbajtja e këtyre lëndëve të përvetësohet në nivelin e kënaqshëm nga nxënësit ato i zgjedhin si lëndë zgjedhore.

Nga të dhënat e mbledhura nga nxënësit del se lëndët më të pranishme në arsimin fillor si lëndë zgjedhore janë: Edukata shoqërore, Matematika dhe Ekologjia dhe Mjedisi.

Grafiku 16. Lëndët zgjedhore sipas klasave



Në grafikun 16 shohim se në klasën e dytë të arsimit fillor lëndët që më tepër mësohen si lëndë zgjedhore janë: Higjiena dhe shëndeti, Matematika dhe edukata shoqërore.

Në klasën e tretë fillore, lëndët që më së shpeshti mësohen si lëndë zgjedhore janë: Edukata shoqërore, Matematika dhe Njeriu dhe natyra.


Në klasën e katërtë si lëndë zgjedhore më së shpeshti mësohen Matematika, Higjiena dhe shëndeti dhe edukata qytetare, ndërsa në klasën e pestë Ekologjia dhe mjedisi, Edukata fizike dhe Gjuhë Shqipe.

Sipas Udhëzimit Administrativ për organizimin e mësimit zgjedhor,”për mësimin zgjedhor, në bazë të kërkesave të të interesuarve, vendosin organet profesionale të shkollës në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Arsimit para fillimit të vitit shkollor”.¹⁵

Por, në realitet *Kush merr vendim për lëndën, kursin e mësimit zgjedhor?*- Këtë pyetje e kemi parashtruar për drejtorët dhe mësime dhënësit e përfshirë në hulumtim.

Në bazë të dhënave të mbledhura, shumica e drejtorëve të shkollave pohojnë se për lëndën e mësimit zgjedhor vendos këshilli i shkollës.

Grafiku 17. *Kush merr vendim për lëndën zgjedhore?*




Në grafikun 17 shohim se 36.4% e drejtorëve pohojnë se për lëndën, kursin e mësimit zgjedhor vendimin e merr Këshilli i shkollës, 9.1% pohojnë se vendimin e merr drejtori i shkollës, 18.2% pohojnë se organet profesionale janë ato që e marrin këtë vendim, 9.1% pohojnë se për lëndën zgjedhore vendos mësime dhënësi, ndërsa 27.2% e drejtorëve nuk kanë

¹⁵ Udhëzim Administrativ: Organizimi i mësimit zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, faqe 2

dhënë përgjigje në këtë pyetje. Përderisa drejtorët e shkollave pohojnë se për kursin, lëndën e mësimin zgjedhor vendos Këshilli i shkollës, mësimdhënësit pohojnë se për këtë gjë vendosin vet mësimdhënësit.

Grafiku18 . Kush vendos për mësimin zgjedhor



Në grafikun 18 shohim se 21.3% e mësimdhënësve pohojnë se për lëndën zgjedhore vendos Këshilli i shkollës, 13.1% pohojnë se vendimin e merr drejtori, 6.6% Organet profesionale, 55.7% pohojnë se vendosin vet, ndërsa 3.3% e mësimdhënësve nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

Siç shohim, numri më i madh i mësimdhënësve vendimin për lëndën zgjedhore e marrin vet. Nga të dhënat më sipër shohim se ka dallime në mes të përgjigjeve të drejtorëve dhe mësimdhënësve

Përgjigjet e dhëna janë shumë të shpërndara, që do të thotë se vendimi për këtë kurs, lëndë mësimore nuk merret sipas udhëzimeve të dhëna nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Në tabelë shohim se vendimin për lëndën zgjedhore e merr mësimdhënësi i klasës për klasën e vet, ngase ata e dinë më së

miri çka është e nevojshme për nxënësit e tyre dhe nuk e shohin të nevojshme të konsultohen me mësime dhënëse të tjerë.


	Drejtorët	Mësime dhënësit
Këshilli i shkollës	36.4	21.3
Drejtori	9.1	13.1
Organet profesionale të shkollës	18.2	6.6
Mësime dhënësit	9.1	55.7
Pa përgjegje	27.2	3.3

Tabela 14. Kush merr vendim për lëndën zgjedhore

Edhe koha e përzgjedhjes së lëndës, kursit me zgjedhje ka rëndësi të madhe sepse ndikon në planifikimin dhe organizimin e mirëfilltë të kursit, lëndës. Për mësime dhënësit dhe drejtorët kemi parashtruar pyetjen: *Kur bëni përzgjedhjen e lëndës së mësimit zgjedhor?*

Nga të dhënat që morëm përmes hulumtimit mësojmë se lënda, kursi apo përmbajtja e lëndës me zgjedhje bëhet para fillimit të vitit shkollor, në fillim të vitit shkollor apo gjatë vitit shkollor. Nga paraqitja grafike shohim se numri më i madh i mësime dhënëseve pohojnë se zgjedhja e lëndës zgjedhore bëhet para fillimit të vitit shkollor dhe në fillim të vitit shkollor, por ka mjaft mësime dhënëse të cilët pohojnë se zgjedhjen e bëjnë gjatë vitit shkollor.


Grafiku 19. Koha e zgjedhje së lëndës zgjedhore sipas mësimdhënësve



Gjatë vitit shkollor zakonisht bëhet përzgjedhja e lëndëve apo kurseve të cilat janë planifikuar të mos zgjasin gjatë tërë vitit. Këto lëndë apo kurse ndërrohen çdo tremujor ose çdo gjysmë vjetor.

Në bazë të të dhënave të mbledhura nga drejtorët, del se zgjedhja e lëndëve, kurseve të mësimit më zgjedhje bëhet para fillimit të vitit shkollor apo në fillim të vitit shkollor. Shumica e drejtorëve pohojnë se kursi, lënda apo veprimtaria zgjedhore përzgjidhet para fillimit të vitit shkollor.

Grafiku 20. Koha e zgjedhjes së lëndës zgjedhore



Nëse bëjmë një krahasim mes përgjigjeve të mësimitdhënësve dhe drejtorëve të shkollave mund të themi se nuk ka dallime të mëdha.

	Drejtorët	Mësimitdhënësit
Para fillimit të vitit shkollor	72.7	49.2
Në fillim të vitit shkollor	27.3	39.3
Gjatë vitit shkollor	-	11.5

Tabela 15. Koha e përzgjedhjes së lëndës zgjedhore


Se lënda, kursi i mësimit zgjedhor përzgjidhet edhe gjatë vitit shkollor, këtë të dhënë nuk e kemi nga drejtorët e shkollave, ndërsa 11.5% e mësimitdhënësve e pohojnë një gjë të tillë.

3.6. Planifikimi i mësimit zgjedhor

Sikurse për lëndët tjera, edhe për mësimin zgjedhor përgatiten plane dhe programe mësimore. Sipas Udhëzimit administrativ dhe udhëzimeve të dhëna në Planet dhe Programet Zyrtare të hartuara nga MASHT-i, planet dhe programet për lëndën zgjedhore i harton shkolla në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Arsimit dhe profesionistë të lëmive përkatëse nga komuniteti.¹⁶ Për të parë se sa përfillet një kërkesë e tillë në praktikën shkollore, për drejtorët dhe mësime dhënësit kemi parashtruar pyetjen:

Kush i harton planet dhe programet për lëndën e mësimit zgjedhor?

Grafiku 21. Hartuesit e planeve dhe programeve për mësimin zgjedhor




Në grafikun 21 shohim se planet dhe programet për lëndën e mësimit zgjedhor hartohen nga mësime dhënësit e klasave. Sipas drejtorëve dhe mësime dhënësitve ndonjëherë edhe nxënësit marrin pjesë në këtë proces. Nga të dhënat e marra nga mësime dhënësit dhe drejtorët del se planet dhe programet për

¹⁶ Udhëzim Administrativ: Organizimi i mësimit zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, faqe 3

vet ata ku, 1.6% e mësimitdhënësve pohojnë se nuk kanë fare plane dhe programe për lëndën zgjedhore.

A marrin pjesë nxënësit në hartimin e programeve mësimore të lëndës së mësimit zgjedhor?- Këtë pyetje e kemi parashtruar për drejtorë dhe mësimitdhënës. Sipas të dhënave të mbledhura 19.7% e mësimitdhënësve pohojnë se nxënësit marrin pjesë në hartimin e programeve mësimore të lëndës së mësimit zgjedhor.

Grafiku 22. Pjesëmarrja e nxënësve në hartimin e planeve dhe programeve mësimore sipas mësimitdhënësve




Sipas tyre, roli i nxënësve në hartimin e programeve mësimore është si: bashkëpunimin me mësimitdhënës apo pjesëmarrja e tyre në ndonjë temë të caktuar. Ndërsa, 80.3% e mësimitdhënësve pohojnë se nxënësit nuk marrin pjesë në hartimin e planeve dhe programeve mësimore. Nga të dhënat e mbledhura shohim se arsyet pse nxënësit nuk marrin pjesë janë të ndryshme. Disa nga mësimitdhënësit, mendojnë se për shkak të kushteve në të cilat punojnë nuk është e mundur përfshirja e nxënësve në hartimin e planeve dhe programeve mësimore. Ata mendojnë se për tu pyetur nxënësi, lëndën zgjedhore duhet ta mbaj arsimtari adekuat. Kjo nuk praktikohet. Mësimitdhënësit e klasave e mbajnë këtë lëndën dhe hartojnë vet planet dhe programet, aty ku e shohin të arsyeshme. Meqenëse ata e njohin mirë strukturën e klasës, zgjedhin përmbajtje që

nevojiten më tepër për nxënës, por që gjatë vitit shkollor ato mund të ndryshohen ngase shfaqen nevoja të ndryshme për lëndë dhe përmbajtje të ndryshme.

Në shumicën e rasteve, hartimin e planeve dhe programeve mësimore për lëndën zgjedhore e bëjnë mësimitdhënësit e aktivitet ose vet mësimitdhënësi i klasës. Edhe pse nxënësit duhet paraprakisht të njoftohen me lëndën zgjedhore, kjo nuk ndodh, por mësimitdhënësit kur vendosin i njoftojnë nxënësit për arsyen e mbajtjes së asaj lënde zgjedhore. Planet dhe programet e mësimit zgjedhor bëhen duke u bazuar në libër. Sipas tyre, nxënësit e arsimit fillor nuk mund të marrin pjesë në hartimin e planeve dhe programeve mësimore, ngase nxënësit e kësaj moshe nuk posedojnë aftësi për të hartuar plane dhe programe mësimore. Ka edhe mësimitdhënësit të cilët nuk dëshirojnë të dalin nga shabllonet e vjetra dhe pohojnë se nxënësit nuk i përfshijnë në hartimin e planeve dhe programeve mësimore ngase *kështu kanë vepruar prej fillimit* dhe nuk e shohin të arsyeshme që nxënësit të ngarkohen me hartimin e programeve të lëndës zgjedhore.

Grafiku 23. Pjesëmarrja e nxënësve në hartimin e planeve dhe programeve të mësimit zgjedhor sipas drejtorëve




Bazuar në të dhënat që kemi nga drejtorët, del se nxënësit janë bukur shumë të përfshirë në hartimin e planeve dhe programeve të lëndës/ kursit të mësimit zgjedhor. Kështu, 40%

e drejtorëve pohojnë se nxënësit marrin pjesë në hartimin e planeve dhe programeve të mësimiit zgjedhor, ku sipas tyre, roli i nxënësve është në përzgjedhjen e lëndës zgjedhore dhe përcaktimin e temave mësimore. Duke pasur parasysh nevojat dhe zhvillimin e teknologjisë, drejtorët mendojnë se nxënësit kanë interesim më të madh në hulumtimin e njohurive dhe paraqesin interesim për tema të caktuara.

Nuk këtë pyetje, 60% e drejtorëve pohojnë se nxënësit nuk marrin pjesë në hartimin e programeve mësimore, ngase sipas tyre “nxënësit konsiderohen të pa ndikim dhe të pa denjë në këtë aspekt”. Nga të dhënat e cekura më lartë pamë se një numër i mësimdhënësve por edhe një pjesë e drejtorëve pohonin se roli i nxënësve në hartimin e planeve dhe programeve mësimore qëndron në propozimin e temave mësimore për lëndën zgjedhore.

Për të parë se sa nxënësit janë aktivë në propozimet e tyre, kemi parashtruar pyetjen: *A i propozoni mësimdhënësit tema ose njësi mësimore që dëshironi t’i mësoni?*

Grafiku 24. A propozojnë nxënësit tema/njësi mësimore?




Në grafikun 24 shihet se 44.3% e nxënësve mësimdhënësve u propozojnë tema apo njësi mësimore që dëshirojnë t’i mësojnë, prej tyre, 68.42% pohojnë se mësimdhënësi i merr për bazë këto propozime, ndërsa 31.58% pohojnë se mësimdhënësit nuk i marrin parasysh propozimet e tyre.

Numri më i madh i nxënësve, 55.7% pohojnë se nuk propozojnë asnjëherë tema apo njësi mësimore për mësimdhënësit. Arsyetimet e nxënësve pse ata nuk e bëjnë një gjë të tillë janë të ndryshme, ku 62% e nxënësve të cilët nuk propozojnë tema apo njësi mësimore të cilat kishin dashur ti mësojnë në lëndën e mësimit zgjedhor mendojnë se mësimdhënësit duhet ti zgjedhin lëndën dhe temat që do ti mësojnë.

Sipas tyre, mësimdhënësit e dinë se çka është më e nevojshme për tu mësuar. Për këtë, 38% e nxënësve pohojnë se nuk ndihen të lirshëm të propozojnë tema/ njësi mësimore, frikësohen se i qorton mësimdhënësi, iu pëlqen ajo që zgjedhin mësimdhënësit, mendojnë se nuk kanë të drejtë ta bëjnë një gjë të tillë, apo mendojnë së ashtu është plani dhe programi dhe nuk mund të ndryshohet.

Lënda zgjedhore ofron mundësi jashtëzakonisht të mirë që përmbajtjet e zgjedhura për këtë lëndë, kurs apo veprimtari të përshtaten me specifikat dhe nevojat e mjedisit lokal.

Për të parë se sa kjo mundësi shfrytëzohet nga mësimdhënësit, është parashtruar pyetja: *Sa përfaqësohen specifikat dhe nevojat e mjedisit lokal në programet e mësimit zgjedhor?*



Grafiku 25. Përfaqësimi i specifikave dhe nevojave të mjedisit lokal në planet dhe programet të lëndëve zgjedhore


Në grafikun 25 shohim se, 63.9% e mësimeve mendojnë se specifikat dhe nevojat e mjedisit lokal përfaqësohen mjaftueshëm në programet e mësimi zgjedhor, 19.7% mendojnë se përfaqësohen pak, ndërsa 16.4% mendojnë se nuk përfaqësohen aspak. Në grafik shohim se shumica e mësimeve pohojnë se specifikat dhe nevojat e mjedisit lokal mjaftueshëm përfaqësohen në planet dhe programet e mësimi zgjedhor.

Gjatë planifikimit të lëndës zgjedhore është me rëndësi edhe përzgjedhja e materialit dhe mjeteve mësimore ndihmëse për këtë lëndë. Nga të dhënat e sipërshënuara është konstatuar se hartimin e planeve të mësimi zgjedhor e bëjnë vet mësimeve, e që ndonjëherë përfshihen edhe nxënësit.

Por: *Kush e bënë përzgjedhjen e materialit dhe mjeteve ndihmëse mësimore për lëndën e mësimi zgjedhor?*

Kjo pyetje u është parashtruar nxënësve dhe mësimeve.


Grafiku 26. Përzgjedhja e materialit mësimor



Mësimeve janë përgjigjur se përzgjedhjen e materialeve dhe mjeteve ndihmëse e bëjnë vet ata. Për këtë, 55.7% e mësimeve pohojnë se përzgjedhjen e materialit dhe mjeteve ndihmëse për lëndën e mësimi zgjedhor e bëjnë vet mësimeve, 39.3% thonë se materialet dhe mjetet

mësimore i zgjedhin në bashkëpunim me nxënësit, ndërsa 4.9% e mësimdhënësve pohojnë se materialet dhe mjetet mësimore për lëndën e mësimit zgjedhor i përzgjedhin nxënësit. Afërsisht të njëjtat përgjigje i kemi marrë edhe nga nxënësit.

Grafiku 27. Përzgjedhja e materialit mësimor



Në grafikun 27 shohim se 54.5% e nxënësve pohojnë se librin dhe mjetet ndihmëse mësimore për lëndën e mësimit zgjedhor i zgjedhin mësimdhënësit, 39.9% pohojnë se mësimdhënësit në bashkëpunim me nxënësit zgjedhin librin dhe mjete e tjera mësimore për këtë lëndë, ndërsa 5.5% e nxënësve pohojnë se librin dhe mjete ndihmëse mësimore për lëndën e mësimit zgjedhor i zgjedhin vet nxënësit.

A përgatitini materiale kreative për mësimin zgjedhor?- ishte pyetja për nxënës dhe mësimdhënë, ku 56.9% e nxënësve të përfshirë në hulumtim pohojnë se për lëndën zgjedhore përgatisin ilustrime, skica, fotografi, bëjnë vizatime, të cilat i vendosin në mure dhe shërbejnë për konkretizimin e mësimit. Ndërsa 43.1% e nxënësve pohojnë se nuk përgatisin asnjë lloj materiali për këtë lëndë ngase, në lëndën e mësimit zgjedhor punojnë me libër, vetëm mësojnë dhe shpjegojnë, se nuk e kanë lëndën e përshtatshme, iu mungon materiali apo gjëra të tilla i bëjnë në lëndën Punë dore.

Nga të dhënat e mbledhura del se mësimdhënësit janë ata që përgatisim më shumë materiale kreative për këtë lëndë. 88.5%


e mësimdhënësve pohojnë se përgatisin se materiale të ndryshme, varësisht nga tema që zhvillohet, si: ndonjë vizatim, skicë, fotografi p.sh. nga ndotja e ambientit, foto të sëmundjeve të ndryshme, ilustrime, modele të ndryshme, me letër, punim dore, etj. Ndërsa, 11.5% e mësimdhënësve pohojnë se nuk përgatitin materiale kreative ngase bazohen në tekstin përkatës të zgjedhur në fillim të vitit shkollor.

3.7. Vështirësitë në realizimin e mësimit zgjedhor

Gjatë realizimit të mësimit zgjedhor paraqiten vështirësi të shumta. Përmes këtij hulumtimi janë mbledhur të dhëna edhe për vështirësitë me të cilat ballafaqohet shkolla me rastin e organizimit të mësimit zgjedhor dhe përkrahja që iu nevojitet mësimdhënësve për ti tejkaluar këto vështirësi.

Sipas drejtorëve të shkollave, vështirësitë më të shpeshta të cilat i hasin gjatë realizimit të mësimit zgjedhor në shkolla kanë të bëjnë me mungesën e kuadrit adekuat, zgjedhjen e lëndëve/kurseve, mungesën e literaturës së nevojshme për këtë lëndë dhe mungesën e mjeteve dhe kabineteve.


Grafiku 28. Vështirësitë në realizimin e mësimit zgjedhor



Në grafikun 28 shihet se 54.55% e drejtorëve të shkollave pohojnë se vështirësitë e hasin në zgjedhjen e mësimit dhe në përcaktimin e mësimit për lëndën zgjedhore respektivisht në mungesën e mësimit dhe profesionist për ligjërimin e disa lëndëve të cilat do të ishin në interes për nxënësit.

Mësimi zgjedhor nuk është i përcaktuar sipas kërkesave dhe talenteve që kanë nxënësit, 18.18% e drejtorëve pohojnë se nuk u jepet mundësi nxënësve të shprehin interesimet e tyre. Po ashtu, 18.18% e drejtorëve si vështirësi e shohin edhe mungesën e literaturës se nevojshme, ndërsa 9.09% prej tyre pohojnë se mungesa e kabineteve dhe mjeteve mësimore paraqitet si vështirësi gjatë zgjedhjes, planifikimit dhe realizimit të mësimit zgjedhor.

Grafiku 29. Vështirësitë e mësimit dhe në përcaktimin e mësimit për lëndën zgjedhore



Edhe mësimit dhe në përcaktimin e mësimit për lëndën zgjedhore e shohin si sfidë për ta.


Gjatë mësimit paraqiten vështirësi të ndryshme. Për këtë aspekt, 36.07% e mësimit dhe në përcaktimin e mësimit janë shprehur se vështirësitë më të mëdha i shkakton mungesa e teksteve mësimore për

lëndët zgjedhore. Gjatë realizimit të mësimit zgjedhor, 21.31% e mësimeve pohojnë se hasin në vështirësi edhe me mungesën e mjeteve të punës, (videoprojektor, fotokopje, kompjuter, letër, hamer, ngjyrë, etj.). Për këtë, 13.10% e mësimeve mendojnë se në mungesë të kuadrit të nevojshëm, lënda zgjedhore nuk përcaktohet me kohë, nuk pyeten prindërit e as nxënësit, 9.84% prej tyre pohojnë se një lëndë zgjedhore përsëritet disa vite dhe kalon në monotoni të nxënësit.

Edhe në hartimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve mësimore për lëndën zgjedhore mësimeve hasin në mjaft vështirësi, ku 8.20% e mësimeve pohojnë se kanë vështirësi në hartimin e planeve dhe programeve, ndërsa 6.56% e mësimeve vështirësitë i hasin në realizimin e planeve dhe programeve. Sipas tyre, nuk mundet një mësime të aftësojë nxënësit në të gjitha lëndët mësimore. Për shkak të ngarkesave të mëdha, siç pohojnë ata, planet dhe programet mësimore shpeshherë nuk mund të realizohen.

Për të tejkaluar vështirësitë të cilat dalin gjatë realizimit të mësimit zgjedhor, është e nevojshme që mësimeve tu ofrohet përkrahja e nevojshme. Mësimeve pohojnë se gjatë organizimit të mësimit zgjedhor ju nevojitet përkrahje në disa aspekte.

Grafiku 30. Përkrahja e nevojshme për mësimdhënësit



Në grafikun 30 shihet se përkrahja më e madhe që iu nevojitet mësimdhënësve ka të bëjë me planifikimin e mësimi zgjedhor. Nga të dhënat e hulumtimit del se 47.5% e mësimdhënësve kanë nevojë për përkrahje gjatë procesit të hartimit e planit dhe programit të mësimi zgjedhor, 32.8% të mësimdhënësve përkrahja iu nevojitet për arritjen e rezultateve mësimore, 9.8% të mësimdhënësve iu nevojitet përkrahja në përzgjedhjen e materialeve dhe mjeteve mësimore, 3.3% prej tyre kërkojnë përkrahje në vlerësimin e nxënësve, ndërsa 6.6% e mësimdhënësve kanë nevojë për tekste dhe materiale mësimore për realizimin e kësaj lënde.

Por, sa u ofrohet kjo përkrahje mësimdhënësve? Për të parë se sa drejtorët u ofrojnë përkrahje mësimdhënësve, në pyetësorin për drejtor kemi parashtruar pyetjen: *Çfarë përkrahje ju ofroni mësimdhënësve në lidhje me organizimin e mësimi zgjedhor?*. Sipas të dhënave që morëm nga drejtorët e shkollave del se përkrahja më e madhe që u ofrohet mësimdhënësve ka të bëjë me zgjedhjen e lëndës zgjedhore dhe dhënia e ideve për tejkalimin e vështirësive.

Vështirësitë	Frekuenca	%
Në përzgjedhjen e lëndës që do të zhvillohet	4	36,4
Në përzgjedhjen e materialit mësimor	1	9,1
Përkrahi duke dhënë ide	2	18,2
Orientoj drejt arritjes së rezultateve	1	9,1

Tabela 17. Përkrahja të cilën drejtorët e ofrojnë për mësimdhënësit

Nën tabelën 17 shohim se 36.4% e drejtorëve të shkollave pohojnë se u ofrojnë përkrahje mësimdhënësve në përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore që do të zhvillohen, 18.2% e drejtorëve pohojnë se mësimdhënësve u ndihmojnë duke u dhënë ide rreth përzgjedhjes së lëndës, mënyrës së planifikimit dhe realizimit të mësimiit zgjedhor, 9.1% e tyre ndihmojnë mësimdhënësit duke i orientuar ata drejt arritjes së rezultateve me nxënës, ndërsa 9.1% u ofrojnë mbështetje në përzgjedhjen e materialit mësimor.

3.8. Komentet e pjesëmarrësve në hulumtim

1. Komentet e drejtorëve të shkollave

Sipas drejtorëve të shkollave, aplikimi i mësimit zgjedhor gjithsesi ka ndikimin e vet pozitiv në formimin e personalitetit të nxënësit. Tretmani për lëndët e mësimit zgjedhor duhet të jetë korrekt si nga ana e drejtorëve të shkollave ashtu edhe nga vet personeli arsimor në mënyrë që të arrihen synimet dhe objektivat e dëshiruara. Sipas tyre, mësimi zgjedhor është i domosdoshëm. Përveç njohurive është relaks dhe iniciativë për arsye se e rritë vetëbesimin tek nxënësit për të shfaqur dhe realizuar idetë, talentin dhe shkathtësitë e tyre. Komentet e dhëna nga drejtorët e shkollave kryesisht janë fokusuar në:

- i. rëndësinë që ka mësimi zgjedhor për nxënësit,
- ii. krijimi i kushteve të përshtatshme për realizimin e mësimit zgjedhor,

Sipas tyre, organizimi i mirëfilltë i mësimit zgjedhor ka rëndësi të madhe ngase:

- përcaktohet në bazë të përgatitjes dhe dëshirës së nxënësit dhe prindit,
 - ka ndikimin e vet pozitiv në formimin e personalitetit të nxënësit,
 - përveç njohurive që ofron, është relaks dhe iniciativë për arsye se e rritë vetëbesimin tek nxënësit për të shfaqur dhe realizuar idetë, talentin dhe shkathtësitë e tyre,
 - ndihmon në zgjerimin e njohurive dhe shkathtësive për jetë,
- Për ta realizuar me sukses lëndën, kursin apo veprimtarinë e mësimit zgjedhor sipas drejtorëve të përfshirë në hulumtim është e nevojshme që:
- Mësimin zgjedhor ta bëjmë sa më interesant për nxënës që të kenë interesim për të mësuar,

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë të përgatis kuadro për mësimin zgjedhor,
- Nxënësit dhe prindërit të marrin pjesë në zgjedhjen e lëndëve të tilla, të ligjërohen këto lëndë nga mësimdhënës profesionist dhe të veçantë për lëndët e tilla,

2. *Komente të mësimdhënësve*

Sipas mësimdhënësve, mësimi zgjedhor duhet të mbahet sipas kriterëve të caktuar në Planet dhe Programet Zyrtare. Mësimi zgjedhor si lëndë me zgjedhje të lirë duhet ti plotësoj nevojat dhe specifikat e lokalitetit ku vepron shkolla dhe të konkretizohet me mjete mësimore por ka edhe mësimdhënës të cilët mendojnë se mësimi zgjedhor është i tepërt dhe ngarkesë për nxënësit sepse të gjitha informacionet e nevojshme nxënësit i marrin prej lëndëve të detyrueshme.

Komentet e mësimdhënësve lidheshin me:

- i. kushtet e organizimit të mësimin zgjedhor,
- ii. rëndësinë e lëndës, kursit apo aktivitetit zgjedhor,
- iii. nevojën për lëndë zgjedhore

Sipas mësimdhënësve, mënyra e organizimit të mësimin zgjedhor varet nga kushtet që ofron shkolla, sepse:

- Lënda nuk mund të mbahet ashtu si duhet, sepse nuk kemi objekt, tekste të nevojshme,por edhe arsimtar adekuat për këtë lëndë,
- Sa i përket mësimin zgjedhor kjo lëndë zhvillohet normal në shkollën tonë dhe përvetësohet shumë mirë nga ana e nxënësve të kësaj shkolle,
- Mësimi zgjedhor duhet të mbahet sipas kriterëve të caktuar në plan-program, nxënësit vet zgjedhin çka do

të mësojnë (formohen grupet dhe mësimin e mban arsimtari i caktuar),

- kushtet në të cilat punojmë nuk i plotësojnë aspak kushtet, p.sh. jo pastërtia, numri i madh i nxënësve, kushtet materiale jo të mira nga nxënësit, etj.

Lënda, kursi apo veprimtaria për mësimin zgjedhor ka rëndësi të madhe, ngase sipas tyre lënda zgjedhore :

- është lëndë funksionale dhe e nevojshme për nxënës,
- është lëndë e cila i përgatit nxënësit për jetë dhe i njofton ata për shëndetin, edukimin shëndetësor dhe higjienën,
- është një lëndë e nevojshme dhe duhet të funksionojë si lëndë e mirëfilltë,
- është lëndë e cila i njofton nxënësit për aftësim në jetë, për shëndetin, edukimin shëndetësor, etj.
- Është lëndë shumë e rëndësishme dhe iu ndihmon nxënësve që të gjejnë vetën në lëndët tjera në qoftë se janë mbrapa në to,
- Mësimi zgjedhor është i dobishëm për nxënës sepse janë më të lirë të flasin, të shprehën lirshëm, të përgatisin materiale kreative sipas dëshirës, etj.

Pjesën e komenteve mësimdhënësit e kanë shfrytëzuar edhe për paraqitjen e kërkesave të tyre. Kërkesat e mësimdhënësve janë të ndryshme, si:

- për mësimin zgjedhor kërkojmë tekste adekuate për secilën klasë,
- MASHT të përpiloi një plan-program për mësimin zgjedhor,
- mësimin zgjedhor ta mbaj ndonjë mësimdhënës që përgatitet për atë lëmi, për atë që nxënësi ka nevojë,
- të sigurohen mjete pune, mjete për demonstrimin e njësive që zgjedhen,

- të zgjedhim lëndën e cila është më e nevojshme për nxënës, jo të imponohet nga ministria, DKA,

Sipas mësimdhënësve, mësimi zgjedhor si lëndë me zgjedhje të lirë duhet ti përfaqësoj nevojat dhe specifikat e lokalitetit ku vepron shkolla. Nëse jepen sqarimet me kohë do të jetë e dobishme kjo lëndë mësimore. Mësimdhënësit janë edhe autokritik duke thënë: “mësimdhënësit duhet të bëjnë më tepër rreth arritjes së rezultateve në mësim zgjedhor, mos ta lajmë pas dore”, por edhe pohojnë se mësimi zgjedhor “është i tepërt dhe ngarkesë për nxënësin, sepse të gjitha njohuritë nxënësi i merr prej lëndëve të detyrueshme”

1. Komentet e nxënësve

Komentet e nxënësve më tepër janë të fokusuar në ndryshimet që do të dëshironin ti bënin në shkollë, sesa në aspektin e funksionimit të mësimi zgjedhor.

Shumica e nxënësve do të ndryshonin librin e mësimi zgjedhor, sepse sipas tyre mësimi zgjedhor është për të ofruar përmbajtje të reja. Siç duket, nxënësve u shkakton monotoni përdorimi i shpeshtë i teksteve të njëjta. Gjithashtu ka mendime se tekstet të cilat i kanë në përdorim janë të pakuptueshme.

“Unë do të doja që të bënim projekte të ndryshme për këtë lëndë, disa projekte në të cilat nuk ka fitues por thjeshtë ne shprehim mendimin tonë”- thotë një nxënës. Shihet se nxënësit kanë ide kreative, dhe për mësimin zgjedhor propozojnë të kenë diçka që më ndryshe se në lëndët e tjera.

Ka edhe nxënës të cilët janë të kënaqur me lëndën zgjedhore. Ka nxënës të cilët shprehen se nuk do të ndryshonin asgjë sepse lënda që kanë ju pëlqen shumë.

IV. GJETJET KRYESORE TË HULUMTIMIT

4.1. Gjetjet që kanë të bëjnë me përkufizimin e mësimit zgjedhor

- Rreth 54% e drejtorëve pohojnë se lënda zgjedhore është lëndë me zgjedhje të lirë e cila në momentin që zgjedhet merr statusin e lëndës së rregullt,
- Rreth 80% e mësimitdhënësve pohojnë se lënda zgjedhore është lëndë me zgjedhje të lirë, e cila zgjedhet nga mësimitdhënësit dhe ka për qëllim plotësimin e njohurive të nxënësve aty ku mbesin mbrapa në mësim,
- Rreth 8.2% e mësimitdhënësve pohojnë se nuk e kanë të qartë statusin e lëndës zgjedhore. Sipas tyre kjo lëndë nuk e ka as statusin e lëndës së obligueshme e as të lëndës me zgjedhje të lirë.
- 50% e drejtorëve të përfshirë në hulumtim pohojnë se arsyeja e organizimit të mësimit zgjedhor në shkollën e tyre është plotësimi i njohurive të nxënësve që mbesin mbrapa në mësim,
- Rreth 45% e mësimitdhënësve pohojnë se arsyeja e organizimit të mësimit zgjedhor është zgjedhja e moduleve të ndryshme në bazë të dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesimit të nxënësve,

4.2. Gjetjet që kanë të bëjnë me organizimin e mësimin zgjedhor

- Rreth 45% e drejtorëve pohojnë se mësimin zgjedhor e organizojnë në bazë të Udhëzimit Administrativ: organizimi i mësimin zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar Nr: MASHT [I] 1/2005 Datë: 06.01.2005,
- Rreth 27% e mësimdhënësve pohojnë se mësimin zgjedhor e organizojnë në bazë të Planeve dhe Programeve Zyrtare të hartuara nga MASHT,
- 100% e drejtorëve të shkollave pohojnë se përzgjedhja e mësimdhënësit të lëndës zgjedhore nuk bëhet me konkurs të veçantë,
- 77% e mësimdhënësve pohojnë se mësimdhënësi i lëndës zgjedhore nuk përzgjedhet me konkurs,
- 60% e drejtorëve të shkollave pohojnë se mësimdhënësi i lëndës zgjedhore në arsimin fillor është mësimdhënësi i klasës,
- Rreth 80% e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim pohojnë se mësimdhënësi i klasës i mban edhe orët e mësimin zgjedhor,
- Lëndët e mësimin zgjedhor, si: Edukim Qytetar, Ekologjia dhe Mjedisi, Edukata Shëndetësore, radhiten në mesin e pesë lëndëve që nxënësve ju pëlqejnë më shumë,

4.3. Gjetjet që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e lëndës zgjedhore

- Rreth 45% e drejtorëve të shkollave të përfshira në hulumtim pohojnë se lëndët zgjedhore zgjedhen në bazë të kërkesave të nxënësve,
- Rreth 37% e mësimitdhënësve pohojnë se lënda zgjedhore sugjerohet nga MASHT,
- Rreth 68% e mësimitdhënësve pohojnë se përzgjedhja e mësimit zgjedhor bëhet nga lëndët e obligueshme,
- Rreth 47% e nxënësve të klasës së dytë pohojnë se lënda zgjedhore që e mësojnë këtë vit është Edukata Shoqërore,
- Rreth 35% e nxënësve të klasës së tretë pohojnë se lënda zgjedhore që e mësojnë është Edukata Shoqërore,
- Rreth 36% e nxënësve të klasës së katërt pohojnë se lënda zgjedhore që e mësojnë është Matematika,
- 75% e nxënësve të klasës së pestë pohojnë se lënda zgjedhore që e mësojnë është Ekologjia dhe mjedisi,
- Rreth 38% e nxënësve pohojnë se lëndën zgjedhore e zgjedh mësimitdhënësi,
- Rreth 43% e nxënësve pohojnë se asnjëherë nuk i pyesin për lëndën që do të zgjedhin,
- Rreth 36% e drejtorëve të përfshirë në hulumtim pohojnë se për lëndën, kursin e mësimit zgjedhor vendimin e merr Këshilli i shkollës,
- Rreth 55% e mësimitdhënësve pohojnë se për lëndën zgjedhore vendosin vet mësimitdhënësit,

- Rreth 72% e drejtorëve pohojnë se lënda, kursi i mësimit zgjedhor përzgjidhet para fillimit të vitit shkollor ,
- Rreth 49% e mësimeve pohojnë se lënda zgjedhore zgjedhet para fillimit të vitit shkollor,

4.4. Gjetjet që kanë të bëjnë me planifikimin e mësimit zgjedhor

- Rreth 72% e drejtorëve të shkollave pohojnë se planet dhe programet për mësimin zgjedhor i hartojnë mësimeve,
- Rreth 80% e mësimeve pohojnë se hartojnë vet planet dhe programet mësimore,
- Rreth 80% e mësimeve pohojnë se nuk marrin pjesë në hartimin e programeve mësimore të mësimit zgjedhor,
- 60% e drejtorëve të përfshirë në hulumtim pohojnë se nxënësit nuk marrin pjesë në hartimin e planeve dhe programeve mësimore të mësimit zgjedhor,
- Rreth 55% e nxënësve pohojnë se mësimeve asnjëherë nuk u propozojnë tema apo njësi mësimore që dëshirojnë t'i mësojnë,
- Rreth 44% e nxënësve mësimeve u propozojnë tema/njësi mësimore që dëshirojnë t'i mësojnë në lëndën zgjedhore,
- Rreth 68% e nxënësve të cilët propozojnë tema/njësi mësimore për lëndën e mësimit zgjedhor, pohojnë se mësimeve i marrin për bazë këto propozime,

- Rreth 31% e nxënësve që propozojnë tema/njësi mësimore pohojnë se mësimdhënësit asnjëherë nuk i marrin parasysh këto propozime,
- Rreth 63% e mësimdhënësve pohojnë se në programet e mësimiit zgjedhor përfaqësohen në masë të mjaftueshme specifikat dhe nevojat e mjedisit lokal,
- Rreth 55% e mësimdhënësve pohojnë se përzgjedhjen e materialeve dhe mjeteve ndihmëse mësimore e bëjnë vet mësimdhënësit,
- Rreth 54% e nxënësve pohojnë se materialet dhe mjetet mësimore i zgjedhin mësimdhënësit,
- Rreth 56% e nxënësve pohojnë se për mësimin zgjedhor bëjnë ilustrime skica, fotografi, vizatime, etj.
- Rreth 88% e mësimdhënësve pohojnë se për mësimin zgjedhor përgatisin materiale kreative, varësisht nga tema që zhvillohet.

4.5. Gjetjet që kanë të bëjnë me vështirësitë të cilat shfaqen gjatë realizimit të mësimiit zgjedhor dhe përkrahjen e mësimdhënësve

- Rreth 54% e drejtorëve pohojnë se vështirësitë më të mëdha i hasin në zgjedhjen e mësimdhënësve për lëndën zgjedhore respektivisht në mungesën e mësimdhënësve profesionist për ligjërimin e disa lëndëve të cilat do të ishin në interes për nxënësit,
- Rreth 36% e mësimdhënësve pohojnë se gjatë organizimit të mësimiit zgjedhor vështirësitë më të mëdha iu shkakton mungesa e teksteve mësimore për lëndët me zgjedhje,

- Rreth 47% e mësimeve pohojnë se iu nevojitet përkrahje në hartimin e planeve dhe programeve për lëndën e mësimit zgjedhor,
- Rreth 36% e drejtorëve pohojnë se mësimeve u ofrojnë përkrahje në përzgjedhjen e lëndës zgjedhore.

Diskutim i rezultateve

Nga hulumtimi del se në Republikën e Kosovës për organizimin i mësimit zgjedhor në Arsimin Parauniversitar ka bazë ligjore. Organizimi i mësimit me zgjedhje mbështetet në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Kurrikulën Bërthamë, pjesë e së cilës është edhe Kurrikula zgjedhore, Udhëzimin Administrativ për Organizimin e mësimit zgjedhor në të gjitha nivelet e Arsimit Parauniversitar, në Planet dhe Programet mësimore për klasat përkatëse të hartuara nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë.

Nga të dhënat e mbledhura del se organizimi i mësimit zgjedhor në të shumtën e rasteve mbështetet në rregulloret e brendshme të shkollave, Planet dhe programet zyrtare të hartuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Një numër i konsiderueshëm i mësimitdhënësve nuk kanë informacione se ekziston Kurrikula Zgjedhore e as Udhëzimi Administrativ për organizimin e mësimit zgjedhor. Për këtë arsye, mësimit zgjedhor e rregullojnë në baza individuale apo në bashkëpunim me mësimitdhënës të tjerë të të njëjtës klasë, në të shumtën e rasteve duke zgjedhur ato lëndë të cilat i kanë tekstat dhe materialin e nevojshëm për realizimin e saj.

Në të dhënat e mbledhura ka mospërputhje të mendimeve të drejtorëve dhe mësimitdhënësve brenda shkollës së njëjtë për mënyrën se si shkolla e rregullon funksionimin e mësimit zgjedhor. Dallimet më të mëdha janë në ato shkolla ku drejtorët pohojnë se funksionimin e mësimit zgjedhor shkolla e rregullon në bazë të Udhëzimit administrativ dhe në shkollat ku sipas drejtorit funksionimi i mësimit zgjedhor rregullohet në

bazë të rregulloreve të shkollës. Edhe pse nga drejtorët dhe mësime të mësimdhënësve është cekur mjaft se organizimin e mësimit zgjedhor shkolla e bënë në bazë të rregulloreve të brendshme të shkollës, gjatë realizimit të hulumtimit në shkolla, nuk kemi hasur në ndonjë rregullore të shkollës e cila i orienton mësime të mësimdhënësve se si ta organizojnë mësimin zgjedhor.

Kurrikula Zgjedhore dhe Udhëzimi Administrativ për organizimin e mësimit zgjedhor në arsimin parauniversitar, përcakton edhe statusin e lëndës me zgjedhje, e që kjo lëndë prej momentit kur zgjidhet nga nxënësit dhe miratohet nga organet kompetente, merr statusin e lëndës së rregullt dhe bëhet e detyrueshme për të gjithë nxënësit që e përzgjedhin.

Nga hulumtimi del se statusi i lëndës zgjedhore nuk është ende i qartë për drejtorët e aq më pak për mësime të mësimdhënësve e Arsimit fillor, ngase vetëm 54.5% e drejtorëve dhe 1.6% e mësime të mësimdhënësve e pohojnë një gjë të tillë. Mësimi zgjedhor nga mësime të mësimdhënësve kuptohet si lëndë me zgjedhje të lirë e cila në të shumtën e rasteve zgjidhet nga mësime të mësimdhënësve.

Nga të dhënat e mbledhura përmes këtij hulumtimi vërejmë se mësime të mësimdhënësve por edhe drejtorët e shkollave, mësimin me zgjedhje e ngatërrojnë me mësimin plotësues. Këtë e kuptojmë nga përgjigjet e tyre ku thonë se :*“këtë lëndë e zgjedhim sipas nevojave të nxënësve, aty ku e shohim se ata kanë ngecje, për të plotësuar njohuritë e nxënësve në ato mësim që nxënësit kanë nevojë.”* Po ashtu nga të dhënat kuptojmë se shpeshherë lëndë zgjedhore është njëra nga lëndët e obligueshme, si: Gjuha Shqipe, Matematika, Edukata Qytetare, etj. Këtë e argumentojmë edhe me faktin se 50% e drejtorëve si arsye për organizimin e mësimit zgjedhor e theksojnë plotësimin e njohurive të nxënësve që kanë ngecje në mësim.

Në fakt Kurrikula me Zgjedhje për qëllim ka *“plotësimin e interesimeve dhe nevojave specifike të nxënësve sipas moshës,*

komunitetit dhe vendit”¹⁷, por jo plotësimin e njohurive të nxënësve që kanë mbet mbrapa në mësim. Mësimi zgjedhor organizohet përmes lëndëve, moduleve, projekteve apo njësive tematike të cilat zgjidhen sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit të nxënësve, pra zgjidhet lëndë e re e cila në momentin e zgjedhjes merr statusin e njëjtë me lëndët e Kurrikulës Bërthamë, ndërsa mësimi plotësues ndihmon në plotësimin e njohurive në ato lëndë ku nxënësit për arsye të ndryshme kanë ngec mbrapa në përvetësimin e njohurive dhe zhvillimit të shkathtësive nga lëndët e Kurrikulit Bërthamë. Mësimi zgjedhor organizohet për të gjithë nxënësit, me plan dhe program, brenda orarit të mësimin, si të gjitha lëndët edhe lënda zgjedhore është e paraparë me plan dhe orar mësimor.

Edhe mësimi plotësues gjithsesi planifikohet nga mësimdhënësi, por mbahet para ose pas mësimin të rregullt dhe organizohet vetëm për nxënësit që kanë nevojë, nxënësit që kanë mbet mbrapa në arritjen e rezultateve në lëndë (fusha) të ndryshme të Kurrikulës Bërthamë.

Arsye për organizimin e mësimin zgjedhor në Arsimin fillor sipas shumicës së mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim është zgjedhja e moduleve të ndryshme sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesimeve të nxënësve. Nga të dhënat të cilat dalin gjatë hulumtimit, del se nxënësit shumë pak janë të përfshirë në zgjedhjen e lëndës zgjedhore. Lënda zgjedhore del të jetë zgjedhje e mësimdhënësit. Mësimdhënësi përzgjedh dhe vendos vet për lëndën zgjedhore, por në disa raste në fillim të vitit bëhet një diskutim me nxënësit duke i njoftuar ata me lëndën e re dhe rëndësinë e saj për nxënësit dhe komunitetin në përgjithësi. Lëndët Gjuhë Shqipe dhe Matematikë janë më të

¹⁷ Ministria e Arsimin dhe e Teknologjisë (2012): Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor (klasa parafillore, I, II, III, IV, V), faqe 96

shpeshta që zgjedhen për mësim zgjedhor. Këto dy lëndë janë të pranishme në të gjitha klasat e Arsimit fillor. Ky fakt i hedh poshtë edhe pohimet e mësimdhënësve dhe drejtorëve se lënda zgjedhore sugjerohet nga MASHT-i. Nëse i analizojmë Planet dhe Programet mësimore të hartuara nga MASHT-i, vërejmë se vetëm në klasën e parë të Arsimit fillor për mësimin zgjedhor sugjerohen “*orë plotësuese nga lëndët e obligueshme*”¹⁸, ndërsa për klasën e dytë, të tretë, të katërtë dhe të pestë, nga MASHT-i sugjerohet që mësimi zgjedhor “*të organizohet nga lëndë apo kurse të reja*”.¹⁹ Në bazë të dhënave që kemi, del se në Arsimin fillor lëndët më të shpeshta që zgjedhen për mësimin zgjedhor janë lëndët Edukim Qytetar dhe Të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, ndërsa përzgjedhja e lëndës zgjedhore bëhet para fillimit të vitit shkollor ose në fillim të vitit shkollor.

Zgjedhja e mësimdhënësve të lëndës zgjedhore nuk bëhet me konkurs të veçantë. Orët e mësimit zgjedhor në arsimin fillor i mban mësimdhënësi i klasës apo mësimdhënësi lëndor, i cili nuk e ka fondin e plotë të orëve. Mendimi dominues i mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim është se lënda e mësimit zgjedhor është ngarkesë për mësimdhënësit e klasave. Sipas tyre, për këtë lëndë duhet të zgjedhet mësimdhënësi përkatës i cili do të ofrojë programin e përshtatshëm dhe do të jetë i kualifikuar për atë lëndë. Në realitet, orët e mësimit zgjedhor në të shumtën e rasteve po shërbejnë për plotësimin e normës së mësimdhënësve.

Udhëzimi Administrativ nuk e përcakton qartë se për lëndën zgjedhore a do të jetë mësimdhënësi i veçantë apo mësimdhënësi i klasës. Sipas Udhëzimit, “do të ishte dashur të

¹⁸ Ministria e Arsimit e shkencës dhe e Teknologjisë (2003): Plani dhe Programi Mësimor për klasën e parë fillore, faqe 13

¹⁹ Për këtë shih Planet dhe Programet zyrtare të hartuara nga MASHT-i për klasën e dytë, të tretë, të katërtë dhe të pestë, faqe 15

konkurrojnë arsimtarët e papunë me projekt komplet (lëndën, kursin apo veprimtarinë dhe planin, programin, tekstin dhe mënyrën e realizimit).”²⁰ Mendojmë se kjo do të ishte e përshtatshme edhe për mësimdhënësit të cilët kanë nevojë për plotësim të fondit të orëve, të cilët paraprakisht duhet të konkurrojnë me projektin e lëndës që ofrojnë.

Sipas Udhëzimit Administrativ dhe udhëzimeve të dhëna në Planet dhe Programet Zyrtare të hartuara nga MASHT-i, planet dhe programet për lëndën zgjedhore i harton shkolla në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Arsimit dhe profesionistë të lëmnive përkatëse nga komuniteti.²¹ Rezultatet e hulumtimit tregojnë se planet dhe programet e mësimi zgjedhor i hartojnë vet mësimdhënësit. Nxënësit nuk janë të përfshirë në hartimin e planeve dhe programeve mësimore. E vetmja “përfshirje” e nxënësve në këtë proces është bashkëpunimi në ndonjë temë të caktuar, për të cilën nxënësi do të konsultohet paraprakisht me mësimdhënësin. Sikurse përzgjedhja e lëndës, edhe hartimi i planeve dhe programeve mësimore bëhet në bazë të teksteve që posedojnë mësimdhënësit.

Gjatë realizimit të mësimi zgjedhor shkolla ballafaqohet me vështirësi të shumta. Nga të dhënat e mbledhura nga drejtorët e shkollave rezulton se vështirësitë më të mëdha i hasin në përcaktimin e mësimdhënësve për këtë lëndë, respektivisht ballafaqohen me mungesën e mësimdhënësve profesionistë për ligjërimin e disa lëndëve të cilat do të ishin me interes për nxënësit. Mësimdhënësit pohojnë se mungesa e teksteve mësimore për mësimin zgjedhor po shkakton telashe në realizimin e mësimi zgjedhor.

²⁰ Udhëzim Administrativ Organizimi i mësimi zgjedhor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, faqe 2

²¹ Po aty, faqe 3

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se në organizimin e mësimit zgjedhor rolin kyç e luan teksti mësimor. Nga tekstet varet përzgjedhja por edhe planifikimi e lëndës zgjedhore, që do të thotë se i vetmi burim i informacionit që po shfrytëzohet aktualisht nga mësime të mësimdhënësve është teksti mësimor.

Përkrahja më e madhe që iu nevojitet mësime të mësimdhënësve ka të bëjë me planifikimin e mësimit zgjedhor, me mënyrën e arritjes së rezultateve, përzgjedhjen e materialeve mësimore, dhe vlerësimin e nxënësve. Nga të dhënat e mësime të mësimdhënësve del se përkrahja që u ofrohet nga drejtorët nuk është e mjaftueshme. Përkrahja për mësime të mësimdhënësve nuk është e orientuar në bazë të kërkesave dhe nevojave të mësime të mësimdhënësve.

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1. Përfundime

Rezultatet e hulumtimit, të cilat përputhen me qëllimin, detyrat dhe me hipotezat e parashtruara për zgjedhjen, planifikimin dhe realizimin e mësimit zgjedhor na ofrojnë mjaft mundësi për të nxjerrë përfundime.

Hulumtimi është bërë përmes pyetësorit që kishim përgatitur për drejtor të shkollave, mësime dhënë dhe nxënë. Përzgjedhja e të anketuarve (drejtorëve, mësime dhënë dhe nxënë) është bërë në disa komuna të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Junik, Malishevë, Ferizaj, Drenas dhe Skenderaj.

Organizimi i mësimit zgjedhor në Arsimin fillor në Republikën e Kosovës është i rregulluar me dispozita ligjore dhe me dokumente bazë të hartuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, të cilat e rregullojnë funksionimin e Arsimit Parauniversitar. Legjislacioni shkollor, Kurrikula Zgjedhore e cila është pjesë e Kurrikulës Bërthamë, Planet dhe Programet Zyrtare të hartuara nga MASHT ofrojnë mundësi të mira për organizimin e mësimit zgjedhor.

Planifikimi dhe organizimi i mësimit zgjedhor bëhet në bazë të Planeve dhe Programeve Zyrtare dhe në bazë të teksteve mësimore që posedojnë mësime dhënë.

Mësimi zgjedhor nuk kuptohet drejt as nga drejtorët e shkollave e as nga mësime dhënë. Shpeshherë ngatërrohet me mësimin plotësues dhe mësimin shtues, e që në fakt mësimi zgjedhor nuk është i njëjtë ngase mësimi zgjedhor duhet të organizohet për të gjithë nxënësit, dhe jo të gjithë nxënësit kanë nevojë për mësim plotësues apo për mësim shtesë.

Dominon mendimi i mësimdhënësve se mësimi zgjedhor organizohet me qëllim që nxënësit të kenë mundësi të zgjedhin module të ndryshme sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit, por rezultatet e hulumtimit tregojë se zgjedhja e lëndës zgjedhore bëhet nga mësimdhënësit, në bazë të sugjerimeve të dhëna nga MASHT në Planet dhe Programet mësimore zyrtare të klasave përkatëse. Edhe planifikimi i mësimit bëhet nga mësimdhënësit. Nxënësit nuk janë të përfshirë në planifikimin e mësimit zgjedhor. Ndihet nevoja për pasurimin e planeve dhe programeve mësimore me risi, e sidomos nevoja e përfshirjes së nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e lëndës zgjedhore.

Zgjedhja e mësimdhënësit të lëndës zgjedhore nuk bëhet me konkurs. Në Arsimin fillor mësimdhënësi i klasës i mban edhe orët e mësimit zgjedhor.

Mësimi zgjedhor ofron mundësi që nxënësit të zgjedhin module sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit të tyre. Shumica e drejtorëve pohojnë se lëndët zgjedhore zgjidhen në bazë të kërkesave të nxënësve, ndërsa nga pohimet e mësimdhënësve dhe nxënësve rezulton se lëndën zgjedhore e zgjedh mësimdhënësi pa iu dhënë mundësi nxënësve të deklarohen për lëndën/kursin që dëshirojnë ta zgjedhin. Në fakt, del se organizimi i mësimit zgjedhor mbetet obligim vetëm i mësimdhënësit, dhe mos koordinimi i punëve dhe mospërfshirja e të gjithë akterëve, ndikon edhe në realizimin jo të mirëfilltë të mësimit zgjedhor.

Përzgjedhja e lëndëve zgjedhore bëhet nga lista e lëndëve të sugjeruara në planet dhe programet zyrtare të hartuara nga MASHT, ku numri më i madh i lëndëve zgjedhore përzgjidhet nga lëndët e obligueshme.

Sa i përket përzgjedhjes së lëndës zgjedhore rezulton se shkolla nuk është transparente. Në këtë aspekt mungon bashkëpunimi

me nxënës, prindër dhe me komunitet. Nxënësve, prindërve e as të interesuarve tjerë nuk u jepet mundësi të deklarohen dhe të zgjedhin në bazë të dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit. Ky hulumtim evidentoi një varg vështirësish të cilat paraqiten gjatë realizimit të mësimit zgjedhor. Mungesa e teksteve dhe mjeteve mësimore, mungesa e kuadrit përkatës, përsëritja e lëndëve, hartimi dhe zbatimi i planeve dhe programeve mësimore janë disa nga vështirësitë të cilat mësimdhënësit ballafaqohen në vazhdimësi. Për këtë është e rëndësishme tu ofrohet përkrahje e nevojshme. Përkrahja më e madhe që mësimdhënësve u nevojitet lidhet me planifikimin mësimor. Nga hulumtimi del se mësimdhënësve në këtë aspekt nuk u ofrohet përkrahje e nevojshme për tejkalimin e vështirësive. Drejtorët pohojnë se përkrahjen që u ofrojnë mësimdhënësve ka të bëjë me përzgjedhjen e lëndëve që do të zhvillohen.

5.2. Rekomandime

Përfundimet e nxjerra nga hulumtimi kanë mundësuar nxjerrjen e rekomandimeve, të cilat do të ndihmonin në organizimin mirëfilltë të mësimit zgjedhor në Arsimin fillor.

❖ **Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

- Të sigurohen mekanizma për informimin e shkollave (organet udhëheqëse të shkollës, mësimdhënësit, nxënësit), prindërit, komunitetin, etj. për dispozitat ligjore dhe dokumentet të cilat e rregullojnë organizimin e mësimit zgjedhor,

❖ **Për Drejtoritë komunale të Arsimit**

- Të obligojnë shkollat që organizimin e mësimit zgjedhor t'a bëjnë në bazë të dispozitave ligjore dhe dokumente aktuale të cilat e rregullojnë organizimin e mësimit zgjedhor,
- Të ndihmojnë shkollat në përzgjedhjen e mësimdhënësve dhe lëndëve zgjedhore para fillimit të vitit shkollor,
- Mësimdhënësit e lëndëve zgjedhore të zgjedhen në bazë të projekteve që ofrojnë,
- Në bashkëpunim me organet profesionale të shkollave të vendosin për lëndët me zgjedhje të cilat do dalin në bazë të kërkesave të nxënësve, prindërve apo të interesuarve të tjerë,
- Të monitorojnë dhe mentorojnë shkollat me qëllim të tejkalimit të vështirësive që kanë në zgjedhjen, planifikimin dhe realizimin e mësimit zgjedhor,

❖ Për shkollat

- Për organizimin e mësimit zgjedhor të mbështeten në dispozita ligjore dhe dokumentet e hartuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë,
- Zgjedhja e mësimeve dhe lëndëve zgjedhore të bëhet para fillimit të vitit shkollor,
- Zgjedhja e lëndëve zgjedhore të bëhet në bazë të projekteve që ofrojnë mësimeve,
- Te sigurojnë mekanizma përmes të cilëve do të hulumtojnë nevojat dhe interesimet për mësimin zgjedhor,
- Të nxisin dhe do të mundësojnë nxënësve, prindërve dhe të interesuarve tjerë të deklarohen lirshëm për lëndën, kursin apo veprimtarinë që do të zgjedhin për mësimeve,
- Për lëndën me zgjedhje të përfillen deklarimet e nxënësve dhe të interesuarve tjerë, si dhe përzgjedhja të bëhet sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit të nxënësve,
- Në bashkëpunim me DKA-në dhe profesionistë të lëmive përkatëse të hartojë planet dhe programet për mësimin zgjedhor,
- Për mësimin zgjedhor, në bazë të kërkesave të të interesuarve, të vendosin organet profesionale të shkollës në bashkëpunim me Drejtorinë Komonale të Arsimit para fillimit të vitit shkollor,
- Të monitorohen dhe mentorohen mësimeve me qëllim të tejkalimit të vështirësive që do të hasin gjatë realizimit të mësimit me zgjedhje,

❖ **Për mësime të zgjedhura**

- Për mësime të zgjedhura të konkurrojnë me projektin komplet,
- Gjatë planifikimit të mësimit të zgjedhura të përfillohen dëshirat, nevojat, mundësitë dhe interesimet e nxënësve,
- Të përfshijnë edhe nxënës të hartimit të planeve dhe programeve mësimore,
- Të mos zgjedhin tekstin si të vetmin burim informacioni,
- Organizimi i mësimit të zgjedhura të bëhet në bazë të udhëzimeve të dhëna nga MASHT,
- Gjatë realizimit të lëndës zgjedhore të bashkëpunojnë me të gjithë ata që mund të kontribuojnë në këtë drejtim,

❖ **Për nxënës**

- Të deklarohen lirshëm për nevojat dhe interesimet e tyre për lëndën zgjedhore,
- Të bëhen pjesë aktive në të gjitha fazat e planifikimit dhe të organizimit të mësimit të zgjedhura,

❖ **Për prindërit dhe komunitetin**

- T'i kushtojnë kujdes bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në shkollë
- Të paraqesin interesimet e tyre për lëndët, kurset apo veprimtaritë e mësimit zgjedhor,
- Të nxisin debate për tema të cilat janë në interes për nxënësit, shkollën dhe komunitetin në përgjithësi dhe të kërkojnë mundësinë që të kyçen dhe të ndihmojnë në procesin mësimor,
- Të mos ndalen me kërkesat e tyre ndaj shkollës dhe të japin sa më shumë rekomandime për punën në shkollë, derisa shkolla me seriozitet të madh t'i merr në shqyrtim, t'i analizojë dhe t'i marrë parasysh kërkesat dhe rekomandimet e tyre.

BURIMET

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (2002), Fjalor i Gjuhës së Sotme, Botim i dytë i ripërpunuar (me rreth 35.000 fjalë), Botimet Toena, Tiranë.

Grillo, K. (2002), Fjalor Edukimi (Psikologji- Sociologji- Pedagogji), Tiranë.

Musai, B. (2003), Metodologji e mësimdhënies, Pegi, Tiranë.

USAID & AED (2009), Mësimdhënia dhe mësimi në shekullin 21, Doracak për arsimtarët e arsimit fillor, Projekt i arsimit fillor, Shkup.

Woolfolk, A. (2011), Psikologji Edukimi, botimi XI, CDE, Tiranë.

DOKUMENTE ZYRTARE

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (2011), Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (2012), Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor, Prishtinë.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (2003), Plani dhe programi mësimor, për klasën e parë fillore, Prishtinë.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (2004), Plani dhe programi mësimor, për klasën e dytë fillore, Prishtinë.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (2005), Plani dhe programi mësimor, për klasën e tretë fillore, Prishtinë.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (2005),
Plani dhe programi mësimor, për klasën e katërtë fillore,
Prishtinë.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (2005),
Plani dhe programi mësimor, për klasën e pestë fillore,
Prishtinë.

Të tjera:

<http://fjalorshqip.com/>

Pyetësi për drejtor të shkollave

Pyetësi për mësimdhënës

Pyetësi për nxënës

Botues
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37.091.3:373.3(048)

Bytyqi-Beqiri, Lirije

Zgjedhja dhe planifikimi i mësimit zgjedhor në arsimin fillor :
raport hulumtimi / Lirije Bytyqi-Beqiri, Gani Gajraku. - Prishtinë
: Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2013. - 105 f. : ilustr. me ngjyra ;
22 cm.

Parathënie : f. 5-8. – Burimet : f. 103-104

1.Gajraku, Gani

ISBN 978-9951-591-08-9

ISBN 978-9951-591-08-9



9 789951 591089